

KOSTAS MOURSELAS  
**FLOKË FLAKË TË KUQ**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



KOSTAS MOURSELAS

# Flokë flakë të kuq

roman

*Përktheu nga origjinali greqisht*

Maklena F. Nika

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2018

Autori: Κώστας Μουρσελάς (Kostas Mourselas)

Titulli në origjinal: Βαμμένα κόκκινα μαλλιά

Botoi në greqisht: Patakis Publishers

Ky libër është financuar nga

Fondacioni “Kosta & Eleni Ourani”

ΑΚΑΔΗΜΙΑ



ΑΘΗΝΩΝ

dhe

Ministria e Kulturës



Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Elsa Haderaj

ISBN 978-9928-235-89-3

© S. Patakis SA & Kostas Mourselas, Athens, 2011

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## PËRMBAJTJA

### LIBRI I PARË

*Në thellësi ujqërit*

1. Dhurata surprizë.....	13
2. Shkumësi.....	39
3. Rrufjani.....	86
4. Shtëpia publike.....	94
5. Lëndë të brishta.....	145
6. Martesa e parë e Luisit.....	176
7. Metamorfoza.....	229
8. Darka e Fundit.....	253
9. Arratisja.....	286

### LIBRI I DYTË

*Sa keq! Ne jemi një shpikje kaq e mirë dhe e ëmbël...*

10. Mbrëmjet e dëfrimit.....	317
11. Ah, ç' trishtim!.....	346
12. Shëtitja.....	369
13. Çadërzat.....	396
14. Lamtumira.....	402
15. Çështje të tjera të jetës.....	413
16. Dëshpërimi udhëton.....	440
17. Kështu... Kështu... Kështu.....	450
18. Ekzekutimi.....	469
19. (EPILOG) Dhe dielli mbi shtëpinë publike.....	485

## SHËNIM

- Titulli i Librit të Parë është varg i Antonis Fostieris.
- Titulli i Librit të Dytë është pjesë nga një poezi e poetit izraelit Amikai.
- Titulli i Epilogut dhe i Kapitullit të 16-të janë vargjet e Jacques Préver-it.

## Personazhet kryesore

AJISILAO, babaxhani i shoqërisë, u dashurua me Martën.  
ATHANASIA, njerka e Luisit  
ATHINAJA, gruaja e Panajotaros  
ALEKA, gruaja e parë e Luisit  
ANARJIRO, sipërmarrës, bashkëshorti i dytë i Alekës  
ANESTI, xhaxhai i rrëfyesit  
ANTIGONI, motra e Luisit  
ANDONIADHI, stalinisti i shoqërisë, djalë i mirë  
ARGJIRI, kuadër i Partisë Komuniste Greke, oportunist  
ARISTO KRUNGA, vëllai i Evgjenisë, bukëpjekës  
Rrëfyesi ose KOSTANDIN MANOLOPULO, mik i Luisit  
GJIKA, bashkëshorti i Maricës  
DHRAKOPULO, industrialist salce, i martuar me Madonën  
ELENI ose TUINGI, gruaja e Moskos  
EVGJENI KRUNGA, gruaja me të cilën desh u martua Luisi  
EVSTATHIA, teza e Julisë që e ka frikë Zotin  
ELEKTRA, shërbëtorja e Maricës, lezbike  
ILIA, xhaxhai i Luisit  
JULIA, gruaja e rrëfyesit  
KARMEN ose OFELIA, parukiere, e dashura e Luisit  
KRICINI, major në KEN<sup>1</sup> të Korinthit

---

<sup>1</sup> Qendër Trajnimi për Ushtarët e Rinj.

ZOTI TASO, pronari i kafenesë së lagjes  
ZONJA VASILIQI, nëna e Martës, u dashurua me Ilian, xhaxhain  
e Luisit  
ZONJA PATRA, nëna e Llazarit  
ZONJA NORA, e dashura e rrëfyesit  
KOSTANDINO, biri i Harulës dhe i rrëfyesit  
LLAZARI, djali i një të ekzekutuari  
LIAKOPULO, po njësoj, djali i një të ekzekutuari  
LICA, gruaja e dytë e Luisit  
LUISI ose EMANUEL RECINA  
LUIZA, vajza e Luisit dhe e Alekës  
MARTA, dashuria e madhe e rrëfyesit, e dashura e Ajjsilaos dhe më  
vonë gruaja e Liakopulos  
MARICA GJIKA, nëna e Perikliut, nimfomania nga Izmiri  
MARO, gruaja e Perikliut, në Selanik  
MATINA, motra e rrëfyesit  
MELPO, gruaja e Anestit, nga Izmiri  
MENELAO, vëllai i Gjikës  
MOSKO, vëllai i Luisit me nënë tjetër  
BAKALLI, i dashuri i Uranisë  
BERTANI, greko-francezi i çmendur, klouni  
NIKOLAIDHI, njerku i Julisë  
NORA, e dashura me raste e Manolopulos  
VËLLAI I ARISTOS, i ashtuquajturi qeratai  
Njeriu i torturuar, me të cilin u dashurua Marta  
OLLGA, nëna e rrëfyesit  
OLIMBI KRUNGA, gruaja e të ashtuquajturit qerratai  
URANIA, ngasja e lagjes  
PANAJOTARO, shitës fruta-perimesh, i dashuri i Antigonës, motrës  
së Luisit



PANAJOT ANTIPA, babai i Alekës, argjendar  
PAPADHOPULO, drejtori i Rajonit të Policisë  
Babai i rrëfyesit  
PEPA, pronari i tavernës në Eksamilia  
PERIKLIU, djali i Maricës, që me shumë gjasa bën incest  
PERSEFONI DHERTILI, gruaja e Argjirit dhe një nga të dashurat  
e Luisit  
PETRO RECINA, babai i Luisit  
POLIKSENI, gruaja e bukur e Foti Dhemenasë  
SITISTI, mik i Luisit në ushtri  
SOFIA, këngëtarja nga Trikala  
TASULA, të cilën e donte rrëfyesi, më vonë u bë prostitutë  
TATIANA ose MADONA, gruaja e Dhrakopulos, motra e  
Andoniadhit  
DOGANIERI, nofkë e burrit të Fanit  
XAVARA, ushtar, xhaxhai i Luisit dhe i Moskos  
FANIA, motra e Licës, kunata e Luisit  
FATME ose SOFI, holandezja që merrte drogë  
FOTI DHEMENAGA, bashkëpunëtor me gjermanët, maskara  
HARULA, gruaja e Pepës dhe dashuria kalimtare e Luisit dhe e  
rrëfyesit  
HAXARA, librashitësi  
KRISANTHI ANTIPA, nëna e Alekës, vjehrra e Luisit



LIBRI I PARË  
Në thellësi ujqërit

*Fëmijëve të mi, Mihalit dhe Kleopatrës*



## Dhurata surprizë

**E**MANUEL RECINËN, të ashtuquajturin Luis, vetëm një fjalë e karakterizon, një ndajfolje: “pothuajse”. Pothuajse i shkurtër, pothuajse i shëmtuar, pothuajse i bukur, pothuajse dembel, pothuajse i pashkollë, pothuajse ateist. Ç’dua të them me pothuajse ateist? Teksa pothuajse kurrë nuk i shkel këmba në kishë, shkon ndërkohë në varrime, pagëzime dhe martesë, deri edhe te të vetat. Dy. Dhe për pak tre.

Në përgjithësi, nuk është një person dhe aq i pastër. Pothuajse i pastër, pothuajse i moralshëm, pothuajse i pamoralshëm. Me një fjalë, njeri shumë kontradiktor, shumë i ndërlikuar. Një njeri pothuajse i besueshëm. Pothuajse në rregull.

Dhe ja, tani, teksa përpiqem të ta përshkruaj, pothuajse e shoh tek përgatitet për dasmën e tij...

Jo, jo, në atë moment, pak më përpara. Në momentin kur nën presion u detyrua të thotë po-në për martesën e tij. E kanë zënë ngushtë, shumë keq... Por pa prit pak, nuk e nisa mirë rrëfimin. Më parë duhet të kuptosh tipin e tij. Dhe them tipin e

tij, sepse karakterin e një njeriu të tillë është shumë e vështirë që ta njohësh. Nëse ka dhe karakter. Me pak fjalë, njeri që ka parë shumë në jetë, njeri të cilit nuk i gjendet fundi. Si formohen lumenjtë? Në këtë mënyrë. Nisin me mijëra rrëqe të vogla dhe në fund formojnë Evrotën. Evrota është Luisi.

Por përsëri nuk e nisa mirë rrëfimin, teksa nisa të të rrëfej për martesën e tij, por ndoshta do të duhej të të flisja më parë për Fatmenë e tij, sesi u pleksa edhe unë me të, sesi ma prezantoi, dhe pastaj të vazhdojmë me martesën e tij. Kështu është më mirë. Le të flasim, pra, për Fatmenë e tij.

\*\*\*

E shtunë në mesditë. Jam në shtëpinë time, me gruan time të ëmbël, Julian. Kemi vënë pjatat me gjellë në dy tabaka dhe po shohim televizor. Një film *thriller*. E kupton vetë, hamë dhe shohim. Gjëra të zakonshme, rutinë. Asnjë surprizë, asnjë ngjarje. Të gjitha gjërat e frikshme dhe të tmerrshme, siç e di ti, neve “familjarëve” na ndodhin vetëm në fantazinë tonë, në kundërshtim me Luisin, të cilit të gjitha gjërat e frikshme dhe të tmerrshme i ndodhin në realitet. Ne, e kupton, gënjejmë veten në ëndërr. Dhe aty, teksa ëndrra vazhdonte, dring!... Bie zilja e telefonit.

- Kushëri?

Luisi rrallë të thërret në emër. Disa herë të thotë kushëri, herë të tjera vëlla dhe, ndonjëherë, të thotë xhaxha. Për secilin ka nga një nofkë, produkt i frymëzimit të tij. Anargjirit, do të të tregoj edhe për të, i thotë: “Njeriu im i mirë”, sepse ia hoqi qafe gruan e tij të parë, ia mori. Por le të rikthehemi te telefonata:

- Kushëri, kuptoj, mos fol. Në krah ke atë trupvogël tënde.

Bastardi, gjithnjë “trupvogël tënde” e quan Julian, pavarësisht se ajo është shumë e gjatë, pothuajse 1.80 cm. Tip sportiv. Vetëm trupvogël nuk është.

- Ke veshur pantofla, po mban tabakanë, po sheh televizor, po ha, je zhytur në kanapën tënde të thellë...

A thua se më kishte para syve.

- Më dëgjo, pra. Ngrihu, shko te komodina jote, hap sirtarin, merr një tridhjetë mijë nga masuri yt, hipi makinës dhe hajde. Të kam përgatitur një dhuratë të mrekullueshme surprizë, atë që nuk ta dërgova për festën tënde.

“Cilën festë? Ç’po thotë? Se mos është kujtuar ndonjëherë për festën time?”

- Gjeji ndonjë justifikim gruas sate, thuaji se diçka serioze po i ndodh Luisit e gjëra të tilla. Do të të lejojë...

\*\*\*

Kur shkova, e gjeta aty ku buzëdeti kryqëzohet me “Amfithean”, në një kioskë, pikërisht përballë tavernës “Marides”, atje ku është *Rodeo*. Atje po priste.

Dëgjo tani, që ta kuptosh Luisin. Verë, e shtunë pasdite. Ta thashë? Tridhjetë e tetë gradë celsius, universi po merr flakë, pluhur dhe tmerr, miku im, Luisi duke pritur, veshur me kostum, kravatë, dhe një lule te jaka e xhaketës... Sapo e pashë, bëra kryqin. “Nuk ka mundësi...”

- Luis?

- Qepe.

Për herë të parë e shihja të ecte kaq shpejt. Ngaqë nxitonte dukej si çapkën, sikur tundej e përkulej.

- More Luis, ngadalë, kështu si ecën dukesh si pederast. Si ke qenë?

U kthye në një rrugë me dhé në të djathtë të *Rodeo*-s. Tani e kanë asfaltuar, mendoj. Ecte, përkundej, lëvizte gishtat e të dyja duarve. Herë pas here hidhte tinëz edhe ndonjë vështrim rreth tij. Dhjetë metra më poshtë, dolëm në portin e jahteve të Kalamakit. Për herë të parë po e shihja nga kaq afër. Anije, varka, tragete... Dhe shumë pak det. Plot e përplot me anije. Thua se ndodhesha në ndonjë kamp pushimi veror me shtëpi të parafabrikuara. Jahte të mëdha, jahte të vogla... Ngjanin si të parafabrikuara, po të them. Me kabina të mëdha, kabina të vogla dhe, në oborrin e tyre, domethënë në kuvertë, zonja me pantallona të shkurtra, me sutjena, pa sutjena... Vetëm vazot me borzilokë mungonin. Dhe, para bashit të tyre, disa emra shumë mbresëlënës: arkaikë, të huaj, grekë. “Madona”, “Christiana”, “Lucia”... Si shkruajnë jashtë vilave të tyre disa, “Lena”, “Kalliopi” dhe, madje, me alfabet latin? Kështu edhe këtu. Gjëra shumë romantike. Po të rastisi sheh disa trashalugë, me trup të deformuar, tek shullëhen mbi “Christiana-n” e tyre. Dhe, pastaj, miku im, shoh Luisin që kalon mes tyre, kthehet djathtas, majtas, kalon nëpër rrugëza, rrugë dytësore...

- Sikur je në lagjen tënde.

- Lagjja ime është. Qepe.

Dhe befas ngrin në vend.

- Arritëm.

Përpara nesh një jaht, rreth njëzet metra, njëzet direkë, njëzet vela... Prej druri. Lexoj edhe emrin e tij: “Fatmé”.

Para se ta kalonte urën e vogël për t’u ngjitur, ndali pakëz, vështroi orën, hodhi sërish vështrimin majtas-djathtas.



- More Luis, mos po luajmë në ndonjë film policesk?

- Ec, nuk kemi kohë.

Dhe hyri brenda. Pas tij unë. Menjëherë nisi të ma tregojë skafin.

- I mrekullueshëm! Ka radiografët më të mirë, radiogoniometrat më të mirë, barografët...

Pak a shumë kështu i quajti. Dhe vazhdoi:

- Të tregojnë në çdo moment se si është koha në mbarë botën; gjatësinë, gjerësinë, thellësitë, ç'të duash ti të tregojnë.

Shtyp njëkohësisht disa butona, ndizen disa llamba dhe fillojnë të dalin disa letra në formë shiriti. Si dalin kardiogramat? Njësoj. Njësoj si kardiogramë e thjeshtë. Shtyp sërish butonat, ndalen tingujt, fiken dritat.

- Këtu brenda, kushëri, ka katër kabina.

Dhe nisi të hapte disa dyer të vogla. Brava prej bronzi, doreza prej bronzi.

- Kjo këtu është e pronarit.

Raft librash, televizor, pasqyra, disa sixhade të trasha në dysHEME, disa gravura të varura me harta dhe pamje deti; dhe të gjitha të drunjta. Në ngjyrë gështenjë të errët. Të gjitha.

Unë, siç e kupton, vetëm britma nxirrja, gjithë pasthirrma! "Uau! Uau! Uau!" Por pasthirrma më e madhe më doli kur hapi derën e katërt. A e kupton, në kinema, në çaste të tilla apokaliptike hyn njëkohësisht edhe muzika. Momenti kulmor! Sikur bie gongu dhe daullet. Hap, pra, derën e katërt dhe përballë shoh një krevat të vogël dhe mbi krevat një gjysmëlakuriqe. "Uau!" - ia bëra edhe këtu. Vetëm me një palë mbathje. Të bardha. Të tjerat në shesh. Të gjitha.

Përveç syve, që i kishte të mbyllur. “Uau!” - ia bëra, por nuk e humba toruan; u përmbajta. Përballë, një ventilator i vogël që i bënte fresk.

- More Luis, do të ftohet vajza. Mbuloje.

- E pe? - më tha.

Pikërisht në atë çast hapi sytë. Pothuajse të gjelbër, pothuajse të gështenjtë. Do të më thuash ti, a është e mundur kjo? A shkon ngjyra e gjelbër me atë të gështenjtë? Megjithatë, ndodh. I vetmi vend ku mund t'i gjesh të gjitha kombinimet, edhe ato të ngjyrave më të papërshtatshme, janë sytë. Le të themi, shkon ngjyra portokalli me grinë? Te sytë shkon.

- Luis!... - i thotë në atë moment.

U dëgjua dhe nuk u dëgjua. Si psherëtimë ishte zëri i saj. Si sheqer shumë i imët? Ai që bluajmë në mikser dhe shndërrohet në pluhur të imët? Thjesht si pluhur ëmbëlsire. Por Luisi, as nuk ia fërshëlleu. Ia mbylli derën dhe më çoi në dhomën e ngrënies.

- Ulu. Si e do kafënë?

Dhe shkoi në kuzhinë. Hapi dollapët, sirtarët, nxori xhezvet, kutitë, lugët, kur...

- As në shtëpinë tënde nuk i di kështu vrimat.

- Kushëri, pi kafë të vërtetë dhe mos dërdëllit shumë. Kafë italiane, origjinale. Vetëm te “Kafë Greko” në Romë e pi kështu.

Ky është Luisi. Nuk do ta gjesh kurrë aty ku e pret. A mund ta imagjinosh Luisin, i cili jeton normalisht në Perama, në një shtëpi që ngjason me një barakë, a mund ta imagjinosh këtu, në një jaht që kushton miliona duke shërbyer kafënë? E kush? Luisi, që ende nuk ia ka dalë mbanë të përfundojë çatinë e barakës së tij, që të mos pikojë.

Megjithatë, kur Luisi nuk ka ç'të bëjë, shkarkon të gjithë energjinë e tij aty. Në barakën e tij. Aty do ta gjesh duke mbërthyer gozhdë, duke meremetuar, duke lyer. Kudo që gjen drurë të vjetër, eternite të thyera, kompensata të hedhura, llamarina, letra bitumi, atje i grumbullon. Çdo pesë vjet i shton ndonjë hapësirë të re. Prej shtesave, baraka është shndërruar në një gjatovinë njëzetmetërshe. Që të arrish në kuzhinën e tij, duhet të kalosh nëpër korridore, dhoma gjumi, banja, dete, ultësira, male. Madje edhe një zyrë të vogël ka ngritur Luisi atje brenda.

- Këtu shkruaj ditarin dhe letrat.

Madje, ka edhe pus. Bukur. Ma thoshte dhe nuk e besoja. Në dhomën e gjumit të të atit. Brenda. Kur i shkova për herë të parë për vizitë, kishte arritur dy metra thellësi. Hamendësonte se pikërisht në atë vend do të gjente ujë.

Donte të ishte i pavarur. Të kishte ujin e tij, energjinë e tij, kopshtin e tij. Oborrin e barakës e kishte kthyer në kopsht të vërtetë. Por, gjithsesi, problemi i tij më i madh është uji. Kur ia ndërpresin, ngaqë ka harruar apo nuk ka për ta paguar, nuk shqetësohet dhe aq që mbetet për vete pa ujë, por shqetësohet që vuajnë bimët e kopshtit të tij. Kur kthehet dhe i gjen të vyshkura, trishtohet aq shumë, a thua se i ka vdekur njeri. Sa për energjinë elektrike, e ka zgjidhur. Pothuajse. Ka ngritur një turbinë me erë, ka sjellë disa rrangulla, si motorë, bateri apo transistorë, dhe me ta prodhon energji elektrike.

- Propozoj, - më thotë, - që kafetë t'i pimë në kabinën e Fatmesë. Kështu e quajtmë, siç e quajnë jahtin. Fatmé. Do të flasim në qetësinë tonë edhe atje. Nuk di greqisht. Pak fare. Gjysma-gjysma i thotë. Holandeze. Nga Amsterdami. Sa për shoqëri.

Dhe shkuam. Unë u ula në fund të krevatit, te këmbët e saj. Ai, në krye. Në krah të saj.

- Luis! - tha sërish me zërin e saj si pluhur sheqeri.

- Ky është miku im, Kostandini. Manolopulo. Kostandin.

- Gas, - ia bëri ajo.

- Kështu do të të thërrasë. Gas. Emri yt përkëdhelës. Nuk ka nevojë t'i kapësh dorën që të prezantohesh me të. Kapi këmbën. Seriozisht e kam. Njësoj është.

Unë, siç e kupton, nuk e kisha marrë ende veten. Sado që u mundova të hiqesha pak si modern dhe si njeri që i ka kaluar të gjitha këto gjëra të çuditshme, në realitet ngjaja me një nxënës të padjallëzuar, që s'kishte parë botë me sy.

- Kape nga këmba, more pallë! Përderisa të gjeti edhe një emër përkëdhelës, ndoshta të pëlqeu. Dhe, sidoqoftë, është shumë e dehur. Të gjitha i sheh paksa si fushë me lule, paksa të zbehta.

Dhe e kapa nga këmba, pak fare, lehtë, sa për t'i thënë mirë se të gjeta. I dhurova dhe një buzëqeshje. Buzëqeshi edhe ajo dhe i mbylli sërish sytë.

- Me pijen, ia doli mbanë të linte drogën. Pothuajse. Kurse tani, me dashurinë përpiqet të lërë edhe alkoolin. Kur e dashurojnë, i lë të gjitha. Qengj i Perëndisë bëhet. Do ta dashurojnë. Nuk ka rëndësi se kush. Mjafton që ta dashurojnë.

Luisi po më linte gjithnjë e më shumë me gojëhapur. Kurrë nuk do të kisha ëndërruar se do të mbaja në krahët e mi një krijesë të tillë, e shumta njëzetegjashtëvjeçare, më e pakta e bukur, si një kukull dhe që dorëzohej pa kushte. Shumë e qartë, pa kushte. Dhe një femër e tillë, që të dorëzohet pa kushte, është si lotaria që të bie pa e blerë fare

biletën. Natën ëndërron për numrin dhe, kur zgjohesh në mëngjes, konstaton se ai është numri fitues. Papritur lexon, numri i parë fitues 3333 e aq, dhe tmerrohesh. Është bileta që bleve në ëndrrën tënde, natën, kur po flije.

- Luis!

- Më thuaj, shpirt, çfarë do? - iu përgjigj gjithë ëmbëlsi.

- Pak verë.

Dhe Luisi:

- Do të të rrah, e do të të rrah shumë bile.

Dhe nuk u tall. E dallova në sytë e tij. Do ta rrihte. Atëherë u kthye nga unë dhe më vështroi si shpëtimtarin e saj. I them Luisit:

- Nuk janë për moshën time pamje të tilla. Do të iki. Ç'më solle këtu?

E zuri gjumi përsëri. E vështrova sërish. Si duronte, bastardi? Vajza ishte e ëmbël, si sheqer. Sapo bënte një lëvizje të vogël të syve, të këmbëve, të trupit, paralizohesh. A thua se drejt teje po vinin valë të lehta, të padukshme pulsuese. Kështu ndihesha.

Megjithatë, kishte ushtruar shumë herë dhunë mbi të. Donte ta shpëtonte, ta bënte të linte alkoolin, thotë.

- More Luis, të gjitha mund t'i imagjinoja, por të të gjeja në një jaht të sistemuar si në shtëpinë tënde!...

Qeshi. Për të qenë më i saktë, buzëqeshi. Më poshtë, nëse do të më kujtohet, do të të flas me hollësi për buzëqeshjen e Luisit. E pazbërthyeshme, ashtu si themi për elementet kimike, që janë diku te nëntëdhjetë në numër? E, pra, disi e tillë është buzëqeshja e Luisit. E pafajshme, djallëzore, e ngrohtë, e akullt, e zgjuar, naive, ironike, kriminale, e kështu me radhë, sa epitete të duash... Mund të të gjej nëntëdhjetë

epitete dhe të nëntëdhjeta do t'i shkonin për shtat. Kimi me plotë kuptimin e fjalës. Buzëqeshi dhe vazhdoi të ma tregojë historinë.

Thotë se kishte zënë punë këtu, në jaht, si ndihmëskapiten. Kapiten ishte vetë pronari, Renatoja, një italian i pasur e i çuditshëm. Harrova të të them se kohët e fundit profesioni kryesor i Luisit, kryesisht gjatë verës, ishte pilotimi i jahteve. Luisi nuk është rrugaç, punon. Me mënyrën e tij, sigurisht.

- Dëgjo, - më thotë. - Që kur zura punë te Renatoja, përpara tre muajve, nisi edhe historia e Fatmesë. Edhe pse ky Renatoja është shpirt njeriu, e ka një pikë të dobët. Të shëtisë botën dhe të gjejë kukulla në arrati. Një në çdo tre muaj. Kështu e kam përllogaritur. Ndërkohë, këtu me Fatmenë, janë ngatërruar keq gjërat. Sepse përveçse kukull, na qenkësh dhe diçka tjetër. Do edhe verë, edhe pluhur. Mund të harrojë cigaren ndezur dhe t'i vërë flakën jahtit, mund ta fusë në telashe me policinë. Kështu që, dëshiron me çdo kusht, ta heqë qafe. Dhe, madje menjëherë, sot, tani. Kur të kthehet, të mos e gjejë këtu. Ky është problemi. Ku ta çosh?

E vështronim të dy në të njëjtën kohë dhe e shihnim të buzëqeshite teksa flinte. Sigurisht që buzëqeshja e saj nuk kishte asnjë lidhje me buzëqeshjen e Luisit. Tjetër gjë ishte buzëqeshja e Fatmesë. Është vetëm ajo çka sheh, ajo çka tregon. E dëlirët. Nuk fsheh asgjë. E qelibartë. I shkon plotësisht syve të saj. Asnjë mospërputhje. Gjë që nuk ndodh me Luisin. Tek ai ndodh e kundërta, çdo gjë është kontradiktore. Te sytë e tij dallon një pafajësi, që as sytë e Krishtit nuk e kishin, dhe një buzëqeshje të padepërtueshme,

djallëzore. Në atë moment vura re se po e mbaja ende nga këmba, në kyç.

Rrëfimi i Luisit më kishte rrëmbyer vërtet. Sigurisht tani, Fatmeja ishte duke ëndërruar. E kuptuam nga thithkat e gjoksit të saj. I pari e vuri re Luisi. E pabesueshme! Papritmas i shohim të zmadhohen, sikur i përkëdhelte dhe i ngacmonte ndonjë dorë e padukshme.

- Edhe më vjen keq për të, kushëri. Si ta flak në rrugë? Të uritur dhe pa një dyshkë në xhep. Ai do që ta flakim në rrugë, nuk i intereson fare, i palëkundur.

Sigurisht, që ta kuptosh tamam Luisin dhe të gjitha këto që po të them, nevojiten më shumë hollësi, na mungojnë copëza të ndryshme të jetës së tij që të krijojmë mozaikun për të. Kështu e shoh jetën e tij, si një mozaik me mijëra variante, modele dhe ngjyra. Kisha, shtëpi publike, zogj, pemë dhe det. Mbi të gjitha, Luisi nuk do të mund të jetonte gjatë larg detit. Dhe, meqë nuk mund të siguronte një mjet lundrimi, një ditë gjeti një truall afër detit, aty ku kishte ngritur barakën e tij, në Perama. Por, në atë kohë bëri një gabim në përllogaritje, sepse atë e zuri gjatë verës, kur nuk kishte shira dhe nuk vërshonin përrenj. Por, në dimër, kur pothuajse e kishte ngritur dhomën e tij të parë në atë ndërtesë, pa leje ndërtimi, zbuloi, disi me vonesë, se pikërisht në atë vend kalonte edhe një përrua që derdhej në det, i cili ia shkatërroi të gjitha. Por ishte vonë që të hiqte dorë. Kishte rënë në dashuri me atë truall, kishte mbjellë pemët e para, limonin e parë. Për tre vjet ngriti një digë. Kështu i detyroi, të ashtuquajturat ujërat e shiut, të ndryshonin disi rrjedhën e tyre. Kishte fituar betejën me elementet e natyrës. Madje nga entuziazmi i madh që kishte, ngriti mbi murin e digës

edhe një flamur, krijuar sipas frymëzimit të tij. Me sfond të bardhë, dhe pak të zi në mes. Një njollë e zezë, që ngjante si arnë.

\*\*\*

Por s'të kam thënë akoma sesi hyri Fatmeja në jetën e Luisit. Shumë thjesht. Kur Luisi dhe Renatoja u zgjuan një mëngjes, dhe u ngjitën në kuvertë për të tymosur purot e tyre, siç e kishin zakon, gjetën Fatmenë duke fjetur.

- Një engjëll i rënë nga qielli! - thirri i habitur Luisi, që e vuri re i pari.

Renatoja ishte në një mendje me të.

- Engjëll, - tha dhe e mori në mbrojtjen e tij.

Sigurisht, Luisi e quajti engjëll, jo nga ndonjë aspekt fetar apo poetik, por sepse nuk mund ta shpjegonte sesi u gjend ajo në kuvertë, duke qenë se ata e heqin natën urën që lidh anijen me tokën. Gjithashtu, nuk kishte as ndonjë jaht tjetër rreth tyre, që të thuash se kishte kaluar duke u hedhur nga njëri te tjetri. Vetëm duke fluturuar mund të ngjitej dikush. Por, meqë krahë engjëlli nuk u gjetën mbi të ose përreth saj, e gjithë ngjarja mbetet një mister. Dhe kështu do të mbetet, sepse sa më shumë i lutej Luisi t'i zbulonte të fshehtën e saj, aq më shumë ajo nuk pranonte dhe qeshte. Dhe qeshte si e marrë, si e lojtur, si hysterike. Të qeshura të tilla e kapnin. Ai kishte frikë se mos i ndalej fryma nga e qeshura. Kaq shumë qeshte. E papërmbajtur. Sigurisht, e pyeti që t'i tregonte për të fshehtën e saj, pasi më parë i kishte konsumuar të gjitha variantet e mundshme të zbritjes së saj në kuvertë. Them të zbritjes, sepse gjëja e parë që i



erdhi në mendje Luisit ishte helikopteri. Por, edhe në këtë rast, do të ishin zgjuar nga zhurma. Në fund, përpara një misteri të tillë të pashpjegueshëm, Luisi, tashmë i tërbuar, u detyrua që një mëngjes ta kërcëronte me një brisk rroje.

- Të mori lumi, për atë Zot, trego, ose t'i preva damarët!

Dhe e gjakosi pak. Pa dashje. Por gjithsesi nuk dukej se bënte shaka. Ajo nuk nxirrte zë. Madje i zgjati dhe duart në drejtim të tij.

- Pritmi!

Por nuk mundi, nuk arriti, sepse pikërisht në atë moment u dashurua me të. Për një ko incidencë fatlume, në atë moment mungonte dhe mbrojtësi i saj, kështu preferoi ta përqafonte në vend që t'i priste damarët. Dhe e puthi.

Sigurisht, e dashuroi për momentin, sepse Luisi nuk dashurohet kurrë për një kohë të gjatë. Gjithmonë për momentin. Dhe jo gjithmonë detyrimisht në krevat. Jo. Kudo qoftë.

Gjithsesi, mund të të them se që atëherë Luisi filloi të ndiente frikë përpara mistereve të paeksploruara të universit dhe, bashkë me të, të zbulonte dhe absurden. Pranoi kotësinë e gjërave dhe nuk mund ta shpjegonte faktin se ndërsa ekziston vdekja, njeriu në mënyrë krejt absurde, këmbëngul me çdo kusht të jetojë. Shiko ku ka arritur, të vendosë shenjën e barazisë midis misterit të mbërritjes së Fatmesë dhe misterit të ekzistencës, dhe të të thotë se, meqë ky mister ekziston, ti mund edhe të jetosh, edhe të gjesh kuptimin përse jeton. Sigurisht, kur m'i thoshte këto dikur, ishte mjaft i pirë dhe nuk arrija të kuptoja dhe shikoja qartë në atë që thoshte.

Gjithsesi, kaloi në faza të ndryshme, derisa arriti në këtë përfundim. I ishte kthyer në makth të vërtetë misteri i Fatmesë. Ide fikse. Besonte se nëse nuk do ta zgjidhte këtë

mister, do ta kishte të pamundur të jetonte. E pësoi edhe këtë. Ra në depresion të them, u bë melankolik. I lutej:

- Fatmé, të lutem, më thuaj, do të më çmendësh, si u gjende në kuvertë?!

Ajo asgjë. Vetëm qeshte. Derisa në fund Renatoja u tmerrua; shihte se kjo shaka po merrte drejtim të rrezikshëm.

- Shef, nëse nuk do të na e zbulojë...

- Nëse e pyet edhe një herë, je i pushuar. Kaq po të them.

Këtë ia tha anglisht. Luisi dinte edhe anglisht. Tjetër mister. Ku dhe kur e mësoi anglishten? Brisku gjithsesi ishte tentativa e tij e fundit, sepse midis kërcënimit të pushimit nga puna dhe kuriozitetit, Luisi pranoi të jetonte edhe pa e zbuluar atë mister.

- Ç'të bësh... Mund të jetosh edhe kështu.

Që atëherë, sigurisht, sikur u thye diçka brenda tij. Nuk u thye. U kris. Thua se ekzistonte diçka prej qelqi, këtu në dërrasën e kraharorit, pak më lart, që e kemi pak a shumë të gjithë brenda nesh. Kjo u plasarit. Pretendon, madje, por dhe këmbëngul se dëgjoji edhe tingullin. Të qartë. Një kërcitje e çuditshme. Çmendurira. Si ato ngjyrat që përthyhen dhe mbushin plasaritjet. Do ta përshkruajë dhe nuk mundet, nuk gjen fjalët e përshtatshme.

Sidoqoftë, po të them, se që atëherë Luisi ndryshoi, nuk ishte më Luisi i kohëve të vjetra, ai Luisi që njihnim. Kështu të paktën pretendojnë ata që e kanë parë kohët e fundit.

Si fillim braktisi punimet për hapjen e pusit. Nuk gërmoi më asnjë centimetër. Në mes të dhomës së gjumit mbeti një vrimë e stërmadhe, dy metra e thellë. Është një çmenduri, por Luisi jeton në një shtëpi që ka një vrimë dy metra të thellë. Nuk pranon ta mbyllë. Vetëm e ka mbuluar.

Babai i tij nga ky merak do të vdesë. E zbuloi edhe ai këtë gjë absurde. Kjo gjë e kishte pajtuar edhe me vdekjen. E beson? Deri atëherë, ideja e vdekjes e terrorizonte shumë. Tani, plaku i tij është qetësuar.

\*\*\*

Nejse. Ku ndodhemi? A, po. Në kabinëzën e Fatmesë dhe po pimë kafënë. Kur mbaruam kafënë, vazhduam me *Campari*. I fortë dhe i hidhur. Me limon dhe sheqer. M'u duk e çuditshme, kur pashë të hapte me çelës një dollap të vogël që të na sillte pijen. Atëherë më shpjegoi maninë e Fatmesë për alkoolin dhe përse i mbyllnin të gjitha me kyç.

Nuk ta fsheh se, pas gjithë këtyre gjërave të çuditshme dhe të pazakonta, unë ndihesha pak a shumë sikur kisha hyrë në një zonë të minuar. Nga çasti në çast, një Zot e di se ç'na priste. Dhe, sado që të dua të jem njeri modern, pa paragjykime, në fund të fundit edhe shoqërinë e marr parasys, edhe të njohurit, edhe Julian. Madje edhe teze Evstathinë. Sidomos atë. Sepse është edhe besimtare fanatike, edhe e pasur, gjithashtu mbrojtësja jonë. Imagjino, pra, sikur të zbulonte se bashkëshorti i mbesës së saj, domethënë unë, Gasi sipas Fatmesë, frekuentoj jahte në shoqëri të grave gjokszbuluara, që të ofrohen, me italianë të çuditshëm, ku qarkullojnë narkotikë, me... Nuk do të më shpëlante as ujëvara e Niagarës nga ato që do të dëgjoja prej gojës së saj.

- Luis, mos ndoshta duhen marrë disa masa? Mos ndoshta ky Renatoja ka njëfarë të drejte që ka frikë se mos plekset?

Pashë vështrimin që më hodhi dhe ndalova. U turpërova, por vazhdova:

- Sepse, në rastin e Renatos, vlen ajo shprehja “vdekja jote, jeta ime”. Kemi shkruar edhe hartim me këtë temë. Në gjimnaz. Na pyeste Raisi: “Jeni dakord apo kundër?”. Ne që ishim dakord, na përjashtuan dy ditë nga shkolla. Që të dy. Unë dhe ti. “Vdekja jote, jeta ime, përbën rregullin”, patëm shkruar. E mban mend?

E mbante mend, sigurisht, edhe Raisin, edhe përjashtimin nga shkolla.

- Luisi im, - vazhdova, - mos ta humbasim edhe vendin e punës. Jam Sekretar në Gjykatën e Shkallës së Parë, nuk kam shumë hapësira për të bërë numra. Sepse, sigurisht, mundet që teze Evstathia të ketë mundësinë të kontribuojë në njëfarë mënyre në jetën tonë të përditshme, por ki parasysh që është një grua gjashtëdhjetë e ca vjeçare dhe ka tekat e moshës. Nëse nesër ajo do të gjejë njeriun e jetës së saj dhe ndihma ekonomike prej saj do të na shterojë, na mbeten vetëm ato që fitoj duke u marrë me shkresurina. Nëse i humbasim edhe këto, ç’do të bëjmë? Mos arrijmë deri aty sa të mbetemi në mes të katër rrugëve.

\*\*\*

Ndërkohë, Fatmeja vazhdonte të flinte. Thithkat e saj ishin rikthyer në gjendjen e tyre normale, trupi i saj herë pas herë ndërronte pozicion. Ashtu si piktori që i kërkon modelit të tij të ndryshojë mënyrën e qëndrimit, derisa ta gjejë atë që i përshtatet.

Tashmë ishte errësuar. Sapo Luisi shkoi për të ndezur dritat, u dëgjua një bori makine.

- Sollën naftën, - tha dhe iku duke vrapuar.

Kur u hap dera, hapi sytë edhe Fatmeja. Pak. Pastaj më shumë. Kur vuri re mungesën e Luisit, u ngrit ndenjtur dhe duke përfutur nga rasti u hodh sipër meje, thua se rryma elektrike ia përshkoi trupin.

- Gas, më jep *Campar*-in tënd.

Foli me një greqishte të pastër dhe shtriu dorën të ma merrte. E tërhoqa mbrapsht.

- Gas? - tha dhe u mbështoll mbi mua.

E tëra. Kur them u mbështoll, nuk po përdor ndonjë figurë letrare. U çmenda. Që të merrte *Campar*-in tim, ç'nuk bëri. I mbështolli këmbët rreth mesit tim, të dyja duart rreth qafës dhe u ul me gjithë trupin mbi mua. Seriozisht e kam. Me gjithë trupin, mbi mua, vetëm me një palë të mbathura.

- Gas, të lutem, pak.

- Fatmé.

- Sofi.

- Ti, Sofi, jo *Campari*.

Dhe e lashë gotën mbi një tavolinë të vogël, larg saj.

- Gas, hera e fundit.

Përpiqej ta kapte. Nuk mundi dhe u kthye dhe më vështroi në sy. E vështrova edhe unë. Ishte pothuajse fëmijë. Atëherë, me shumë frikë dhe pasion, i mbështolla dhe unë duart rreth mesit të saj. Me kujdes, të mos thyhej.

- Gas, pak.

Nuk durova, u dorëzova. Mora gotën dhe ia afrova në gojë.

- Hera e fundit? Betolesh?

- Hera e fundit, - më thotë dhe filloi ta rrufiste pak e nga pak, me gllënjka.

Kur mbaroi, e mori gotën në duar, filloi ta lëpinte me gjuhë rreth e rrotull buzëve, pastaj qëndroi në gjunjë në krevatin e saj të ngushtë, bëri përpara me gjunjë, hapi dritaren anësore të kabinës së saj, i dha një dhe e hodhi jashtë, në det. Plluq, bëri. Unë i ulur në fund të krevatit, ajo në gjunjë.

Duke ecur sërish me gjunjë në dyshek, u kthye pranë meje. Ngritur gjithnjë mbi gjunjë. Gjoksi i saj tani, në atë pozicion më lart se unë, pothuajse prekte buzët e mia. Merrja frymë në distancë milimetrike nga thithka e saj. “Ajo, në shenjë mirënjohjeje, nuk është ndonjë çudi të...” Dridhesha. Frika ime nuk kishte kufij. Mendoja edhe Luisin, që, kudo që të ishte, do të vinte, edhe pse akoma dëgjohej pompa e cisternës; edhe italianin ndoshta... “A është e drejtë të përfitoj nga rasti? Nuk e di.” Gjithsesi po i mbaja duart të palëvizshme dhe nuk dija ç’të bëja me to. Më në fund e kapa sërish vetëm nga mesi dhe mbeta thujtë si i ngrirë, i pavendosur. Dhe, papritur, pas një pauze të papërcaktuar kohe, ajo u përku dhe më puthi. Në buzë. Me të vërtetë. Ajo. Vetëm më puthi. Më pas u ul pranë meje dhe filloi të qante. Pikërisht në atë moment u ndal edhe motori i cisternës.

- Gas, të dashuroj, - më tha dhe vazhdoi të qante.

Atëherë hyri Luisi.

- Mos u ngri, nuk është e nevojshme. Rri ashtu siç je.

Mori një karrige prej kashte, u ul përballë dhe filloi të ma shpjegonte: Fatmeja ishte dhurata surprizë për festën time, që ma premtoi në telefon.

- Është krijesa më e mirë në botë. I vetmi veprim për të cilin nuk do të pendohesh në jetë, kushëri.

Nuk po kuptoja. Ku donte të dilte? Vazhdoi:

- Ato tridhjetë mijë që solle, ia japim asaj dhe ajo kthehet në atdhe, ose atë e mban ti dhe paratë m'i jep hua mua, meqë kam nevojë.

Fatmeja qante akoma. Me takt. I dinte të gjitha. I kuptonte të gjitha. Të gjitha ato që më thoshte.

- Një melodramë e vërtetë, kushëri. Prindërit e ndjekin nga pas dhe ajo nuk do të kthehet, për asgjë në botë.

- Gas, - më thotë Fatmeja dhe më vështron e pikëlluar.

Luisi vazhdoi:

- Pará ke, more i paudhë. Merr me qira një garsonierë të vogël. Jo për shumë kohë. Për gjashtë muaj. Më pas, nëse nuk e do, ma kthe mua. Mbaje derisa të kthehem nga Egjipti. Nëse e kthejmë në atdheun e saj, te të afërmit, do të fillojë përsëri drogën, do të vdesë. Nuk i do, janë derra. Unë, përveç faktit që do të çaj detin me italianin për në Egjipt, nuk kam as lekë që t'i jap për të jetuar. Ku ta çoj? Ti vazhdimisht më thoshe se unë e jetoj jetën. Ja pra, jetoje dhe ti tani... jetën tënde. Ke rastin. Sa të zgjasë, kushëri. Ajo të do. Ia kam shpjeguar. Pranon gjithçka. Më e shumta derisa të gjejë punë. Sa për Julian tënde, nuk më vret ndërgjegjja, në djall shkoftë.

Gjëra të tilla më thoshte që të më bindte. Më turpëroi. Çfarë nuk më tha. Ç' do t'i bëja paratë që mblidhja? Dhe se një dhuratë e tillë, surprizë, një herë na vjen në jetë.

- Fillimisht do ta çosh në një hotel, pastaj në një garsonierë...

Çaste kritike. A mund të merret një vendim për dy minuta?...

- Deri në moshën njëzetvjeçare, e ka pasur jetën të hidhur si helm. Nuk do të kthehet në atdheun e saj. Ka frikë se do ta vrasin. Italianit nuk ia ka më qejfi që ta marrim me vete. Ia ka prerë dhe biletën. Nuk do të alkoolizuar në anijen e tij.

Iu luta, por asgjë. I thashë, nuk pi më, është shëruar. Përsëri asgjë.

Më vuri në pozitë shumë të vështirë.

- Po si, more Luis? Kaq e lehtë të duket?

Filloi prapë nga avazet e tij. Ai kishte gruan e tij, nuk mund ta çonte në shtëpi.

- Ndërsa gruaja jote nuk do të marrë vesh asgjë. Por vendos shpejt, tani, para se të vijë italiani dhe ta gjejë ende këtu. Ai, me siguri, do ta kthejë mbrapsht në atdheun e saj, për leckash do ta kapë dhe do ta çojë në avion.

Ç'të bëja? Ti ç'do të bëje? Do ta mbaje? Do ta merrje një përgjegjësi të tillë? Pikësëpari, Julia dinte fije për pe se sa pará kishim dhe sa fitoja unë. Deri në qindarkën e fundit çifutja e dreqit. Edhe ato tridhjetë mijë që zhvata, të shoh sesi do t'i justifikoj. Ç'mund t'i thosha nëse ajo do të shihte që mijëshet po zhdukeshin? Lëre pastaj punën time. Në fund të dal dhe i pleksur me banda narkomanësh dhe me gjëra të tilla si këto? Ajo nesër mund të gjendet e varur në shtëpinë e saj, mund të... Ka një mijë "mundet" të tilla. Pale pastaj nëse e nuhat këtë histori teze Evstathia, ngelëm me gisht në gojë. Ka në pronësi një pallat trekatësh në "Patisation", që do t'ia bëjë dhuratë Julisë. Pas vdekjes, sigurisht. Por deri atëherë? Ajo më ka që më ka në shënjestër.

- Nuk bëhet, more Luis, do të gjej belanë. Janë gjëra të rrezikshme...

- Ah, more kushëriri im budalla, - ma bën në fund. - Ti nuk je për Mbretërinë e Qiejve...

- More Luis...

- Dakord, dakord.



Të plasja më vinte. Dhe që mos të tallem me ty, nuk ishte dhe aq problem ana ekonomike, mund të zhatja disa pará po të doja, se ndihesha në njëfarë mase komod ekonomikisht, por...

- More Luis, dëgjo...

- Mirë, mirë, lëre fare. Ke të drejtë. Unë e kam fajin.

Dhe e rrëmben në krahët e tij. E mbante me të dyja duart.

- Luis! - i thotë Fatmeja dhe fillon prapë një të qarë që të këpuste shpirtin, një të qarë!...

As Shën Mëria nuk do ta mbante me kaq dashuri birin e saj, Krishtin. E mbante dhe e vështronte.

- More Luis, më kupto, nuk bëhen këto gjëra. Në rregull, të ndihmoj, por nuk luhet me zjarrin. Dhe nuk bëhet fjalë vetëm për zjarrin...

E mbështet atëherë në krevat, kaq me kujdes, thua se po vendoste ndonjë material të thyeshëm prej kristali, apo ndonjë gjë tjetër, rrëmben një valixhe të vogël, e mbush me rrobat dhe xhinglat e saj, i vesh një këmishë burrash, të bardhë me vija, dhe një palë pantallona të shkurtra, i mbaj mend akoma, të kuqe flakë, si zjarri, si gjaku.

Kur e tërhoqi të dilnin jashtë, Fatmesë i merreshin këmbët. Kur e pashë në këmbë tek ngjiste shkallët, më erdhi të bërtisja, t'i thosha: "Luis, prit, do ta marr dhe në djall vafshin të gjitha". Por u përmbajta. U dëgjua vetëm "Luis". Vetëm sa arrita t'i fusja paratë në xhep. Aq sa kisha. Tridhjetë mijë. Doli jashtë, i hipi motorit të tij të paimagjinueshëm, e uli në ndenjësën e pasme...

- Ku po e çon, more?

- Në Perama, në shtëpinë time. Ku do që ta çoj?

U bëra si i lojtur. Ç'po bën kështu bastardi? Te gruaja po e çon? Dhe nga sa dija, në shtëpi kishte edhe plakun e tij... Iku me shpejtësi.

Që atëherë, shprehjen e tij, “kushëri, nuk qenke për Mbretërinë e Qiejve”, këtu e kam, më ka mbetur si lëmsh në fyt. Nuk kishte arritur madje as t’i mbërthente këmishën dhe, ndërsa largoheshin, dy cepat e saj u hapën dhe tundeshin, thua se po i valëviste flamurin e bardhë armikut të tij.

\*\*\*

Të fola më parë për motorin e paimagjinueshëm, të cilit i hipi Luisi. I paimagjinueshëm, sepse, nga karambolet dhe rrokullisjet e shumta, nuk besoj se i ka mbetur më ndonjë pjesë origjinale nga fabrika që e ka prodhuar. Dhe duhet të dish se, nëse Luisi jeton ende, kjo ndodh vetëm në sajë të mrekullive të njëpasnjëshme. Normalisht, sa herë i hipën motorit, aq herë duhet të kishte shkuar në Botën Tjetër. Por, në çastin kritik, ndërhyjnë gjithmonë një engjëll mbrojtës dhe e shpëton. Nuk i intereson të dijë emrin e engjëllit të tij, apo shkaqet që e bëjnë të ndërhyjë, por është i sigurt se diçka misterioze ndodh. I dashuri im, nuk ka mundësi që t’i shkëputet plotësisht rrota e përparme, të gremiset dhe në fund të ngrihet si zotëri, thua se ishte përkulur të merrte diçka që i kishte rënë. Gjithashtu, nuk ka mundësi që rrota e përparme të përplasët në bordurën e një trotuari, Luisi të shkëputet e të fluturojë si raketë, të bjerë mbi karrocërinë e një mauneje të ngarkuar me shalqinj, që ecte para tij, sepse ka ndodhur edhe kjo, dhe të shohësh atë skenë tragjikomike, në vend që të përplasët ai përtokë si shalqi, ranë shalqinjte. Çmendurira. Dhe, të gjitha këto,

mbaje mend këtë, i pëson jo se është drejtues i keq, por sepse vetëm mbi motor Luisi koncepton ide, thur plane, merr vendime, ëndërron. Në përgjithësi shpejtësia i jep ngacmimet më të forta, e çon në qiell. Ka ndodhur që është nisur nga Perama, ka arritur në Rafinë, ka zbritur nga motori i tij dhe vetëm atëherë ka mundur të zbulojë se kishte më shumë se dy orë e gjysmë mbi motor, pa e ditur.

- Po, kushëri, e pabesueshme. Sapo mbërrita, atëherë e kuptova. Nuk ia kisha idenë që po udhëtoja për dy orë.

Ai, gjatë këtyre dy orëve, kishte konceptuar me mendjen e tij ngritjen e një lokali, kishte gjetur kapitale për financim, partnerë, dhe si ekonomiste gruan e të vëllait, Elenicën, që i thërrisnin edhe Tuingi, të cilën gjithsesi e kishte gjithmonë në vëmendje... Histori e gjatë. Dëgjo që të kuptosh: Ndërsa udhëtonte, kishte menduar se ku do ta ngrinte lokalin - në një shtëpi të vjetër të braktisur - pronaren - një grua shumë të gjatë e joshëse, që madje nuk donte t'ia jepte me qira - e kupton, pra, se deri në ç'pikë kishte arritur ëndrra. Iu desh gjysmë ore, thotë, nga Kalithea deri në Stadhio që ta bindte. Fillimisht e dehu, i luajti pjesë me fizarmonikë - kur Luisi nuk kishte kitarën e tij, ia dilte mbanë edhe me fizarmonikë - e ushqeu dhe me gliko rrushi, në çdo lugë nga një kokërr rrushi. Sidoqoftë, miratimin përfundimtar ia tha në krevat, kur ajo ishte sipër tij dhe ai poshtë. Në fund, me atë britmën drithëruese "burri im je ti", ia dorëzoi shpirtin, trupin dhe lokalin.

Dhe sigurisht të gjitha këto, si të thashë, i sajonte hipur mbi motorin e tij të paimagjinueshëm, duke udhëtuar për në Rufinë. Sigurisht që nuk ishin të gjitha pjellë e fantazisë së tij. Mjedisi ekzistonte, e dinte, edhe ekonomistja, si të

thashë, nusja e vëllait të tij, që kishte studiuar paksa për financë dhe i lutej t' i gjente punë, që ta braktiste të shoqin, se nuk e duronte dot më. Të tjerat i përkisnin imagjinatës së tij. Procedurat dhe sidomos zonja e gjatë. Ajo nuk ekzistonte.

Edhe tani po ashtu, jam i sigurt, derisa të arrijë në barakën e tij, sigurisht, do të ketë trilluar një histori të tërë se si do të veprojë: ose do të ndahet, me detyrim, nga Lica e tij dhe do të marrë Fatmenë, ose më mirë jo, do t' i mbajë më mirë të dyja, edhe Licën, edhe Fatmenë. Do ta bënte modele ose diçka tjetër dhe, më vonë, do ta merrte për grua, ndoshta do t' i hapte edhe ndonjë butik, parukeri, ç' të donte ajo. Në të vërtetë, ëndërrimi mbi motor për Luisin ishte diçka tërheqëse. Mbi të i kishte ëndërruar të gjitha. Edhe me gratë e disa prej xhaxhallarëve kishte shkuar në shtrat. Ato që i pëlqenin. Edhe me gratë e miqve të tij. Ato që i pëlqenin. Edhe ortakët e tij imagjinarë i vodhi. Edhe i torturoi, edhe i tradhtoi për t' u hakmarrë. Dhe, për të qenë më afër realitetit, shumë nga këto nuk kanë ndodhur vetëm në fantazinë e tij. Ëndrra dhe realiteti të Luisi janë kaq pranë dhe kaq të ngatërruara, sa, me siguri, sado histori që të të tregojë, nuk do ta dijë as ai dhe as ti që i dëgjon, nëse i ka jetuar apo jo; si, për shembull, historinë me lokalin, që akoma dhe sot askush nuk e di nëse thjesht e imagjinoi apo e jetoi. Mund edhe ta ketë jetuar me të vërtetë, sepse dikur, në thellësinë e shekujve, nga sa thotë vetë, ka pasur një lokal të tillë. Vetëm një gjëje nuk ia ka dalë mbanë Luisi as në ëndërr. Të vrasë.

Nuk është i zoti për këtë. E pranon edhe vetë. Është pika e tij e dobët. Me gjithë përpjekjet që ka bërë herë pas here, e kishte të pamundur. Shumë herë sillte në mendje armiqtë e tij më të mëdhenj, ose edhe disa miq bastardë, disa tipa,

mungesa e të cilëve do të ishte në favor edhe të shoqërisë dhe të atij vetë, të cilët i çonte deri në atë pikë vulgariteti, sa të justifikonte plotësisht vrasjen e tyre. Nuk përtonte, as atëherë, por ishte e pamundur t'i zhdukte.

Gjithsesi, ndoshta nga ndonjë dëmtim i trurit të tij, shumë herë ngatërronte realitetin me ëndrrën. Dhe e thamë, ëndrrat, të cilat i shihte me sy hapur, duke i dhënë motorit të tij ose duke udhëtuar me trena, makina, anije. Jo në gjumë. Rrallëherë në gjumë. Ato nuk kishin rëndësi për të.

\*\*\*

Nga ato që më tha më pas, ashtu si m'i rrëfeu kur shkova dhe e gjeta në spital, aksidenti kishte ndodhur në çastin kur ëndërronte sikur shëtiste Fatmenë e tij në Dhrapecona, midis pallateve të refugjatëve, në momentin kur njerëzit po protestonin, teksa e shihte dhe e admironte me pantallonat e shkurtra dhe me këmbishën e hapur me vija, përpara dyqanit të qelqurinave *Bocari*. Në atë çast, që ishte në kulmin e ëndërrimit, ndodhi edhe gjëma. Motori, si vetëtimë, u zhyt i tëri në vitrinën e dyqanit. Sepse, si më tha, në momentin që u përplas me vitrinën, i dukej sikur dëgjonte thirrjet admiruese të njerëzve, dhe pëshpëritjet, madje edhe duartrokitjet. Luisi ra mbi një raft me jorganë. Engjëlli i tij mbrojtës ndërhyri sërish. Madje, më tha, këtë herë, pothuajse e kishte parë tek e rrëmbeu dhe e hodhi mbi sfungjerët dhe mbi pambukun e jorganpunuesit, që ishin të ekspozuar në rrugë. Kështu shpëtoi vetëm me disa të nxira dhe shembje të lehta në kokë. Fatmeja, së bashku me motorin, kaloi vitrinën, theu xhamin dhe u ngul te një

antikuar, një llambë e madhe vajguri. Qelqi ngjyra-ngjyra i llambës, i zbukuruar me figura nga mitologjia, me Nimfa dhe Satirë, ia çau hundën, ballin dhe arriti thellë deri në tru. Gjithë pjesa tjetër e trupit nuk i pësoi gjë, as edhe një gërvishtje. Shkëlqente!

Derisa erdhi ambulanca, disa llamba neoni e ndriçonin, dalëngadalë përreth ish-in mbledhur njerëz dhe e admironin; rrugës për në spital - në atë orë kishte dhe trafik të rënduar - ajo mbaroi. Përpara spitalit kishte dhënë frymën e fundit.

- Është e pamundur! - thoshte vazhdimisht Luisi. - Është e pamundur! Fatmeja, engjëlli! Nuk ka mundësi, unë idioti...

Ishte hera e parë që e shihja Luisin të fliste përçart përpara meje, kur shkova dhe e gjeta në spital nën arrest dhe të plagosur.

- Është e pamundur!

## Shkumësi

**D**ASHURIA E LUISIT për mua, mund të them se Erdhi duke u shtuar që prej kohës kur shërbenim së bashku në ushtri, në Korinth. I damkosur dhe ushtar këmbësorie unë, i damkosur dhe ushtar këmbësorie edhe ai. Krevatet tona në fjetore pranë e pranë, pranë njëri-tjetrit në stërvitje, po ashtu dhe kur merrnim masa disiplinore. Që të dy nga Pireu, madje nga e njëjta lagje. Lexonim shumë që të dy, por Luisi më shumë sesa unë, edhe pse nuk kishte mbaruar as gjimnazin.

Një gjë e mërziste, që nuk e kisha shumë për zemër Palamas-in e tij<sup>1</sup>. E kishte mësuar pothuajse përmendësh *Dymbëdhjetë fjalët e Ciganit*<sup>2</sup>.

- Gjëra të kota, nuk më ngjisin, - i thosha. - Fjalë të mëdha, pompoze.

- Jo, kushëri, mos e thuaj këtë.

---

<sup>1</sup> Kostis Palamas (1859-1943), shkrimtar, historian dhe kritik i letërsisë, përfaqësues i Brezit të Viteve 1880 në Greqi.

<sup>2</sup> Vepër poetike e autorit, botuar në 1907-n.

Në atë kohë, Palamas-i ishte ende në kulmin e lavdisë.

Luisi ishte aq i përgatitur, sa nuk mund ta imagjinosh. Lexonte Dostojevksin, Gogolin, por edhe Petro Pikronë<sup>1</sup> dhe, çfarëdolloj reviste letrare që i binte në duar. Ndoshta brenda vetes ishte paksa konfuz, sepse lexonte lloj-lloj librash, zor se e kapje mat. Sidoqoftë, e mërziste shumë fakti se nuk e pëlqejë Palamas-in e tij.

- More Kostandin, askush nuk ka thënë ndonjë fjalë të keqe për të deri tani. Si ka mundësi që nuk të pëlqen?

Atëherë, më kujtohet, e njoha me Kavafis-in. I lexova disa vargje të tij. Nuk e njihte. Thjesht e kishte dëgjuar. Qëllimisht e mora me vete librin e tij, kur u ktheva nga leja. U mërzit sa nuk mund ta marrësh me mend. Nga dita në ditë pa se si u shemb idhulli i tij; iu thërrmua para syve të tij.

- Ç'është ky, more Kostandin? I madh qenka. Madhështor!

Në mbrëmje, në tavernën e Pepës, gati sa nuk qante. Ishte hera e parë që më çoi në tavernën e Pepës, e cila ndodhej rreth tre kilometra jashtë Korinthit, afër Eksamilias. Deri atëherë nuk më kishte folur kurrë për Pepën dhe për tavernën e tij. E shihja disa mbrëmje që merrte Sitistin dhe iknin, por nuk dija ku... Madje, kur nuk kishte leje, kapërcente muret rrethuese, u jepte ryshfet rojave dhe ikte. Atë ditë, pra, kur i lexova Kavafis-in, donte, me zor, të më merrte dhe mua.

- More Manoli, pa leje nuk mundem. Si do të dal jashtë? Është ushtri, nuk bëhet shaka...

Por më bindi... Në fillim kaluam telin me gjemba dhe më pas kapërcyem murin rrethues. Sitisti, që kishte leje, na priste më poshtë.

Kështu njoha Pepën dhe Harulën, gruan e tij. Pepa i urrente komunistët, partinë e tyre dhe mënjollat e saj. Nuk



ke pará në xhep? Merre Pepën në tavolinën tënde, qerase dhe fillo t'i shash banditët dhe gjithë sojin e tyre. Por mos bëj gabim që t'i quash partizanë. Banditë i pëlqen atij. Mallkoji dhe qerase. Në fund, kur t'i thuash "Ilogarinë, zoti Pepa", është gati të të zhdëpë në dru.

E kishte mbushur dyqanin e tij me disa parulla antikomuniste dhe me disa copa kartoni të mbushura me citate patriotike, por të shkruara keq: "Atdheu mbi të gjitha", "Njihni vetveten", "Rroftë ushtria", "Dili për zot vetes" dhe të tilla. Ia kishte sjellë mësuesi i fshatit, i cili kishte vënë fëmijët t'i shkruanin.

Nga afishet, më mbresëlënësja ishte ajo që varej mbi radio. Tregonte një partizan duke përdhunuar një grua që simbolizonte Greqinë. Asnjë nuk shihte përdhunuesin, të gjithë Greqinë shihnin. Rreth e rrotull kishte edhe flamuj të vegjël.

Pepa thotë se e ka paguar shumë shtrenjtë Luftën Civile, sepse banditët i kishin vrarë vëllanë e madh, që e adhuronte dhe e kishte si baba.

- Bastardët, vëllanë tim gjetën, qengjin e Zotit?

Dhe gjëra të tilla. Vetëm për këtë i urrente, por kjo i mjaftonte.

- Mua personalisht nuk më ngacmuan, nuk kam asgjë kundër tyre.

- Zoti Pepa, pa prit pak. Nëse ishte qengji i Zotit, pse e vranë?

E linte bisedën në mes. Shtrembëronte fytyrën në mënyrë të çuditshme dhe ikte. Kohët e fundit kishte filluar të ngatërrohej. Këtë e kishte vënë re edhe Luisi.

Fakti është se kur Recina nuk kishte një dhjetëshe në xhep, atëherë ia hidhte Pepës karemin; fillonte e i tregonte disa anekdota - për Luisin ishte si buka me djathë të rrëfente histori të tilla - dhe ia dilte mbanë. Me pak fjalë, ia kishte gjetur anën Pepës.

Nuk arritëm të uleshim kur ma prezantoi. “Ky, zoti Pepa, kjo zonja Harula”, përshëndetje, buzëqeshje... Kur në një çast dëgjova Luisin të përdorte për komunistët fjalë përçmuese, *komunistët e mutit*, e humba toruan. “Nuk qenkemi mirë, mendova, ai është i Kategorisë së Tretë, ushtar këmbësorie i mbetur komunist muti, i persekutuar, i majtë. Ç’po thotë ky njeri?”

Megjithatë, sapo shqiptoi fjalën “komunistë muti”, u dëgjua urdhri i Pepës, që të sillnin pjatën me herdhe, mezeja e preferuar e Luisit: qofte dhe herdhe.

Herë të tjera, kur Pepa shihte Luisin të hynte te “Harula” e tij - me këtë emër e kishim pagëzuar edhe tavernën, “Harula” - sapo e shihte, e kishte dhënë porositë e tij. “Qofte dhe herdhe.”

E donte Luisin, e pranonte.

- Je i këndshëm, Recina, shumë i këndshëm!

Unë, sigurisht, shumë më vonë e kuptova të gjithë shfaqjen dhe kuptimin e saj. Herën e dytë që shkova, derisa të vinte Pepa, Luisi arriti të më thoshte:

- Kushëri, ti që je i kënduar, nisja ndonjë diskutimi filozofik me Andonin - çmendet për filozofirat - foli për jetën, kotësinë e kësaj jete dhe vdekjen. Do të ta mbajë ison edhe Sitisti. Nuk do të jem për pak kohë. Po ta përsëris, Pepës i pëlqejnë së tepërmi historitë tragjike. Për më tepër, të shkojnë dhe ty për shtat. Edhe festë në u bëftë, aty ti, me atë pamje si të atij

që është në prag të vdekjes. Vetëm në kinema të kam parë të qeshësh, bastard. Nejsë. Nëse i thua Pepës “nuk është jetë kjo, gjithçka është e kotë”, entuziazmohet, fillon të qajë, të qerasë dhe të pijë. Vetëm se, ndonjëherë, qerases edhe ti, mos u trego koprrac. Ai do t’i paguajë në fund.

Dhe kështu u bë. E luaja kaq përsosmërisht pjesën, sa që singerisht në fund fillova të qaja edhe unë bashkë me Pepën. Pija dhe qaja. Sitisti e kishte humbur fare. Tha me vete: “Ç’po ndodh këtu, e kanë seriozisht apo po tallen?”. E kishte humbur. Këtu, Pepa desh bëri vetëvrasje. Me pjatancën e dytë filloi të këndonte “Dy dyer ka jeta”, me okën e tretë - atëherë përdornim okën si njësi matjeje - asnjëri nga ne të tre nuk e kuptoi se po këndonim një këngë partizane dhe revolucionare të Peloponezit “Po bubullin Olimpi, po vetëtin Gjona”. Nuk ishim në gjendje të dinim nëse ishte këngë festive apo këngë partizane. Dhe, të kujtohet, sigurisht, se në atë kohë të burgosnin sa hap e mbyll sytë për hiçmosgjë, e jo më të këndoje, edhe ushtar po të ishe, marshe partizane të “armiqve” të tu. Në atë moment pashë Luisin të mbërrinte i frikësuar, duke mbërthyer pantallonat. Pas tij vinte edhe Harula, po aq e frikësuar. Topolake, por e shkathët në lëvizje. Njëzet e pesë vjeçe e shumta. I thirri që t’i tërhiqte vëmendjen:

- Pepa, qymyri, vrap!

Dhe u përpoq të lidhte gërshetin e saj, me ata flokë krejt si mëndafsh, ngjyrë gështenjë në të verdhë, të derdhur supeve. Ishte kënaqësi ta shihje, ashtu të kuqe flakë dhe të shqetësuar, nga njëra anë duke mbledhur flokët dhe nga ana tjetër duke mbërthyer bluzën.

- More, paske shkalluar që e bëre Pepën të këndoje këngë partizane? - ma përplasi Luisi.

Më vonë, njëherë tjetër, kur Pepës i merreshin këmbët dhe donte me çdo kusht të më tregonte shtëpinë e tij, atëherë fillova të dyshoja për kuptimin e gjithë asaj shfaqjeje, ku më kishte vënë për të luajtur Luisi, sidomos kur konstatova se kuzhina e tavernës lidhej me dhomën e ndenjjes së shtëpisë, pasi kaloje më parë nga një korridor i ngushtë.

Kur shkuam për herë të katërt, kuptova se, në një mënyrë të çuditshme dhe thuajse në të njëjtën orë, Luisit i bëhej urina, “mua më falni dy minuta”. Unë në atë moment mendova se diku tjetër flinte lepuri, pra këtu diçka po luhej, kështu që më lindi dëshira të shihja se ç’po ndodhte.

Gjatë kohës që ne të tre - Sitisti, Pepa dhe unë - po lexonim disa vargje të himnit tonë kombëtar “momente të lavdishme të së kaluarës, që i rrëfejme duke qarë”, kur po qurraviteshim për të kaluarën dhe kotësinë - po çfarë të kaluare domethënë, çfarë kotësie... Ç’të kaluar mund të kesh në moshën njëzet e dy vjeçare, që të të ketë shkuar dëm? - nejse, në atë çast e lashë vetëm Sitistin të vazhdonte shfaqjen dhe unë u ngrita të zgjidhja enigmën.

- Po shkoj dhe unë të urinoj, - u thashë.

Dhe vajta. Kërkoja Luisin. Asgjëkundi. Shkoj drejt kuzhinës. Asgjëkundi. Por edhe Harula nuk dukej; si Luisi edhe ajo. Nuk më mbetej gjë tjetër veçse të hapja një nga dyert që kisha përpara. Të magazinës ose të dhomës së ndenjjes. Zgjodha atë të dhomës së ndenjjes dhe e hapa. Pak, po pak fare. Nuk më panë. Vetëm unë i pashë. Pashë Luisin, me pantallonat gjysmë të ulura, të ulur në një kanape, dhe Harulën, si të thashë, me flokët e derdhur supeve, me bluzën e hequr dhe fundin e ngritur, hipur mbi të duke u tundur. Tundej kaq lehtë, në mënyrë kaq erotike, sa nuk

mund ta besoje. Me gjithë ato kile të tepërta dhe të kishte atë lehtësi lëvizjesh? Thua se ishte në anije kozmike dhe ngjante sikur lëvizte në eter. Kështu rrotullohej sipër tij, në mënyrë ciklike.

Ky imazh nuk më shqitet nga mendja. E beson? Shpina e Harulës lakuriq, flokët e saj deri poshtë, gjinjtë e saj duke u tundur, dhe një kanape e shpifur, një damask i dalë boje dhe i shëmtuar. Përballë bufeja dhe një pasqyrë. E madhe. Një imazh i Lindjes epshore. Deri në atë pikë sa kujtova se po dëgjoja *taximia*-t, ato improvizimet muzike popullore. E di ti, atë muzikë të improvizuar në formë vajtimi të stërzgatur, që luhej dikur nëpër lokale, që nuk gëzonin emër të mirë. Nuk më panë. Mbylla sërish derën pa zhurmë dhe ia mbatha.

Nuk i thashë asgjë Luisit. Sigurisht që u hidhërova dhe ndjeva pikëllim, ngaqë nuk ma kishte treguar këtë sekret të tij. E kisha shumë të vështirë të më zinte gjumi në darkë, në fjetore. Le që më kujtohej skena e tyre dhe shkrihesha i tëri. Harula mund të ishte topolake, por lëvizjet e saj ishin harmonike! Ashtu e ulur mbi Luisin, me fundin e ngritur, me shpinën lakuriqe dhe duke u tundur... Mos e pyet. Isha eksituar kaq shumë, saqë vetëm një prekje dhe do të prishesha.

- Në rregull, Kostandin, - më thotë befas Luisi, që qëndronte krah meje. - Nuk është e nevojshme ta marrësh dhe kaq seriozisht. Ta fsheha, sepse më vinte turp të ta thosha. Jo se e vras mendjen për Pepën, por ti je shumë i mbyllur në vetvete, vëlla, shumë i padalë... Të pashë kur e hape dhe e mbylle derën.

Ishte i zgjuar dhe ai, syrin si shqiponjë. Më kishte parë bastardi. Por kishte edhe ai hallin e tij. Hall të madh...

Harula, po atë mbrëmje, i tha diçka shumë serioze. Me sa dukej ishte shtatzënë. Sigurisht që fëmijën e kishte me të, sepse burri i saj nuk bënte fëmijë. Dhe e dinte. Kishte shkuar nëpër doktorë për të parë nëse e kishte ai fajin, dhe kështu ishte. Steril njëqind për qind, i kishte thënë Haxini, një mikrobiolog në Korinth.

Si t'ia bënte tani Harula, që ishte dymuajshe shtatzënë, si ta bindte Pepën se ndodhin edhe mrekullitë, se edhe doktorët bëjnë gabime, se fëmija ishte i tiji? Sigurisht, po të ishte e nevojshme, Luisi do t'ia dilte mbanë edhe kësaj. Është i aftë ta bëjë Pepën të besojë, jo vetëm se fëmija është i tij, por edhe shumë të tjerë në fshat. Por parapëlqeu të përpiqej për ta bindur Harulën të abortonte.

- Në asnjë mënyrë. Më mirë të vras Pepën, të vras veten, sesa të vras fëmijën tim.

Këto ishin fjalët e fundit që ajo thoshte, pas çdo përpjekjeje të Luisit që ta bindte për të abortuar fëmijën. Nuk i mbetej gjë tjetër përveçse ta bindte Pepën, dhe e bindi. E çfarë nuk i tha: i foli për Sarën e Dhiatës së Vjetër, për mikrobiologun e Korinthit, që me siguri do të ishte komunist, si që në të vërtetë, prandaj dhe e diagnostikoi si steril, nga urrejtja për ideologjinë e tij, për shkencën që mbetet gjithmonë mbrapa jetës, etj. etj...

Por argumenti i tij i fundit ishte edhe më i parezistueshmi:

- Zoti Pepa, pse nuk shkojmë te një mikrobiolog që njohim ne, te një antikomunist? Njoh një të tillë në Pire. Dëshironi?

Dhe kështu u bë. Brenda javës, Luisi, unë dhe Pepa u gjendëm në klinikën e Sidhiropulos në rrugën "Filonos". Sidhiropulo i dha Pepës një si shishe prej qelqi, pa kapak,

me grykë të madhe, e mori me vete dhe e drejtoi në brendësi të klinikës, i tha ta derdhte spermën në shishe.

U ulëm të tre në holl, Luisi, unë dhe doktori, dhe prisnim. Pas tri minutash u kthye edhe Pepa me spermën e tij në shishe. Pas dy ditësh i telefonoi Sidhiropulos. Komunist edhe ai, harrova të ta them, një i njohur i babait të Luisit.

- Jeni në rregull, zoti Pepa, mund të bëni sa fëmijë të doni. Spermë më aktive nuk kam parë deri më sot.

Pepa gati sa nuk u çmend. Që atëherë Luisi më vlerësonte jashtë mase dhe zura një vend të rëndësishëm në zemrën e tij; ah harrova të të them se të gjithë planin ia kisha propozuar unë.

- Me një mijë dhrahmi mund të gjendet një mikrobiolog tjetër, që të vërtetojë aftësinë e Pepës.

Kështu i thashë. Sapo ia hodha idenë Luisit, gati sa nuk më puthi.

- Fantastike! - më tha dhe gjeti menjëherë Sidhiropulon.

I foli për tragjedinë që do të shpërthente, nëse fëmija i Harulës do të lindte dikur, i radhiti vrasjet që do të pasonin njëra-tjetrën dhe se Pepa, si bashkëshort i tradhtuar, nuk e ka për gjë të vrasë nënën, fëmijën dhe të atin. Sidhiropuloja u bind. Nuk ishte e nevojshme t'i jepnim as ryshfet.

- Në rregull, silleni këtu. Dhe ia çuam.

- I madh je, Kostandin! Çfarëdo të më kërkosh, do të ta jap. Ide brilante, madhështore! - më thoshte vazhdimisht Luisi.

Kështu Harula rifitoi jetën e saj dhe në këtë mënyrë do të kthehej gëzimi dhe qetësia në tavernë, sepse, siç edhe do ta kesh kuptuar, sapo Pepa nuhati barkun e fryrë të Harulës, nuk kishte humbur vetëm gëzimi dhe qetësia, por kishte filluar të valonte druri dhe shqelmat.

- Më thuaj, grua, me kë komunist ma bëre?

- Të betohem, i yti është, nuk di...

Sipas Pepës, vetëm komunistët do të mund t'i kishin bërë këtë të keqe. Dajakun e fundit ia dha ditën kur e mori Sidhiropulosi në telefon.

- Mund të bëni sa fëmijë të doni, zoti Pepa.

Në momentin kur po i jepte shkëlmin e fundit, pothuajse në atë moment ra edhe zilja e telefonit! Por tashmë ishte vonë. Me këtë shkëlm të fundit, Harula dështoi.

Kështu, fëmija i Luisit dhe i Harulës nuk lindi kurrë. Atëherë, tavernën e mbuloi një atmosferë e trishtuar.

- Të më dërgojë Zoti një dhuratë të tillë e unë idioti ta humbas!

Pepa gati sa nuk po plaste nga hidhërimi dhe marazi. Arriti në atë gjendje sa i ranë edhe flokët. Jo. Në fillim iu zbardhën dhe pastaj i ranë. Pepës iu copëtua zemra, po të them.

Për tre muaj me radhë u përpoq ta linte përsëri shtatzënë Harulën. E pamundur. I kishte thënë Luisi se një herë në muaj veza binte në mitrën e gruas, dhe aty është problemi, sepse duhet të ketë sinkronizim në kohë. Në momentin kur të bjerë veza, duhet të kesh penetruar edhe ti. Në të njëjtën kohë. I kishte thënë gjithashtu se, mund të kalojë një jetë e tërë dhe të mos qëllojë asnjëherë një sinkronizim i tillë.

\*\*\*

Pepa e kishte ngujuar Harulën në dhomën e gjumit dhe nuk e linte as të vishej. E donte gjithmonë të gatshme. Kur i vinte, të mos vonohej, t'i vërsulej.



- Por, si t'ia bëjmë Andon? Kemi edhe punë.

- Në djall vafshin! Kjo ka më shumë rëndësi.

Kështu që, edhe pse Harula e dinte gjithë lojën - ç'të bënte? - u detyrua, jo vetëm të luante deri në fund rolin e saj, por dhe të ishte sa më shumë bindëse. Pranoi me durim fatin e saj!

Natyrisht, në muajin e tretë Pepës i shteruan fuqitë.

Por, para rrënimit të tij fizik, ndodhi një tjetër, ai ideologjik.

Sot të gjitha këto mund të të duken pak të çuditshme, pak si tragjikomike, por atëherë, në të përditshmen, në fushëbetëjën e Korinthit, merrnin të tjera përmasa.

Kur Luisi u nda me Harulën - pas këtyre ngjarjeve - në përgjithësi diçka u kris, diçka u prish në gjithë atë atmosferë. Taverna sikur u zvogëluar, si të ishte munxosur skena e saj. Herdhet dhe kanat me verë, nuk i sillte Pepa me të njëjtin qejf dhe as nuk filozofonte më. Gjithë nerva ishte, të gjitha ia kishin fajin.

Filloi të shante përsëri shkaktarët që i hëngrën të vëllanë dhe, që atëherë, të gjitha kishin marrë të tatëpjetën në jetën dhe në shtëpinë e tij.

Madje, një natë, për herë të parë Pepa - si i erdhi? - u ul dhe na rrëfeu dhe pse e kishin vrarë të vëllanë. Deri atëherë i shmangej sistematikisht. Nuk donte asnjëherë të fliste për të. Pra rrëkëlleu tri gota verë *Nemeas*, dhe pastaj nisi të na tregojë detajet, domethënë ashtu si ia kishte përshkruar vetë zoti Foti, njeriu që i kishte përjetuar nga afër ngjarjet e asaj nate të vrasjes, meqë ishte edhe dëshmitari i vetëm, siç na tha.

Dhe kështu vazhdonim, duke dëgjuar Pepën që fliste e pinte duke qarë.

- Sepse, po të jetonte sot vëllai im, do të ishte ndryshe fati ynë. Dhe tani, zoti Foti nuk do të gëzonte as Poliksenin dhe as pajën e saj. Tridhjetë e ca dynym me portokaj, veç ullishtave dhe shtëpisë së saj.

- Zoti Pepa, për atë Zot, na i thuaj më qartë. Pas vdekjes së vëllait tënd, kush the se u martua me Poliksenin e tij?

Por Pepa përsëri i mbllaçiste fjalët. Disa nuk donte t'i tregonte, për disa të tjera donte të fliste, kështu që i ngatërronte.

- Kohë të vështira, tinëzare, djallëzore, - na thoshte.

Një gjë është e sigurt se, para se të bënte vitin vëllai i tij, Polikseni po martohej me zotin Foti.

- Kurva... Nuk priti as të bënte vitin.

Nuk e di pse, por për aq kohë sa Pepa po tregonte atë histori, përsëriste vazhdimisht “zoti Foti”, “zoti Foti”, Luisi bëhej edhe më dyshues. Diçka po ia ngrinte nervat, diçka nuk shkonte mirë, diçka nuk ngjiste në gjithë këtë histori.

- Dhe këtë zotin Foti?... A mund ta shohë njeri? Ku ndodhet? - pyeti papritmas.

- Tani? E pamundur. Shpëton a nuk shpëton. Dy infarkte. Me të tretin ikën për lesh.

- Po Polikseni?

- Kurvën, as ta pështyj nuk ia vlen, e jo më ta shoh!

Luisi nuk kishte më asnjë dyshim se ky zoti Foti duhet të kishte luajtur një rol të dyshimtë në gjithë këtë histori. Tashmë kishte filluar ta imagjinonte, a thua si ta shihte në fotografi. Sy të gjelbër në të verdhë, lëkurë e gjelbër në të verdhë, dhëmbë të prishur, ndonjë shenjë plage të thelluar në të djathtë ose në të majtë, afër gojës, vetulla të trasha, i dobët.

Nga rrëfimet e Pepës e imagjinonte me stil imponues, sjellje prej gestapoje, sikur e tërë bota të ishte pronë e tij, a thua se ishte krijuar vetëm për të, nga ata që të detyrojnë t' u ofrosh mezen më të mirë, tavolinën më të mirë. “Kaloni, zoti Foti, uluni, zoti Foti.”

- Po kështu si po na i përshkruan, nuk duket se është nga ndonjë derë e madhe ky, zoti Foti yt, - ia hodhi një fjalë me nënkuptim.

- Nuk është, por mos e hap gojën. Sa për të tjerat, shumë zotëri, njeri shumë i respektuar në të gjithë Korinthin. I madh dhe i fuqishëm. Mjafton një fjalë që ministrat të zbresin këtej nga anët tona. E respektojnë të gjithë. Xhandarë dhe klerikë. Unë nuk kam asnjë ankesë. E kam me Poliksenin. Çfarë faji ka ai? E pëlqeu, dhe u martua me të, interesin e tij pa. Sa për të tjerat, në rregull është. Ç’i kam kërkuar, e kam marrë. Dhe lejen e tavernës ma dhanë, dhe... Një telefonatë prej tij mjaftonte të anuloheshin denoncimet që më kishte bërë inspektori i higjienës. Ai qelbësira mund të jetë ç’të dojë, por u soll si zotëri me mua. Sot e mot.

- Pa prit pak, zoti Pepa. Ç’zotëri? Ti po më thua se ai...

Dhe, befas, Luisit iu kujtua se ku, pothuajse e kishte parë, ashtu siç e imagjinonte atë, zotin Foti. Në pasqyrën përballë kanapesë me krahë, aty ku ulej dikur, kur takohej me Harulën; aty ishte një fotografi e zverdhur nga koha, e vendosur ndërmjet kornizës dhe pasqyrës. Në fotografi ishin tre persona. Dy burra dhe në mes një grua. Iu kujtua edhe gruaja. I kishte bërë përshtypje, madje për këtë e kishte parë me kujdes dhe fotografinë. Iu kujtua se njëri ishte i shkurtër, i ëmbël dhe shpirtmirë. Tjetri i gjatë, pozant, imponues, energjik. Sy dinakë, që nuk qeshnin. Por gruaja ishte disi

e çuditshme, nuk përshkruhet. Jo shumë e bukur. Thjesht tërheqëse. Nëse të kalonte pranë, nuk do ta vije re. Por, nëse mbi të do të binte drita e ndonjë prozhektori, do të mbeteshe gojëhapur. Do të bije në dashuri me të. Me tipare jo dhe aq fine. Pothuajse e shkurtër, pothuajse topolake. Sa më shumë e vështroje, aq më tepër të ëmbëlsohej. Nejse, grua, e lindur për të të tradhtuar. E kuptoje që me vështrimin e parë. Do të ishte shumë naiv, nëse do të dyshoje për këtë.

- A ke ndonjë fotografi të tij? - e pyeti si gjoja pa të keq Luisi, kureshtar për të parë nëse me të vërtetë zoti Foti ishte ai tipi i gjatë i fotografisë.

Pepa u ngrit menjëherë duke u lëkundur dhe shkoi e ia sollti. Ishte fotografia e pasqyrës, ashtu siç e kishte imagjinuar.

- Këtu janë që të tre. Ishin miq dhe fqinjë. E vetmja foto që kam.

Nuk e di nëse të kam thënë ndonjëherë se Luisi, edhe pse nuk i pëlqente fare romanet policore, filmat policorë, kishte një instinkt të tmerrshëm polici. Asgjë nuk i shpëtonte.

Kur e sheh tek të vështron e i shkëlqejnë sytë, i dridhen qerpikët, dije se në atë moment është sinkronizuar në frekuencën tënde, në kilohercët që ti emeton.

- Ky është vëllai yt? - e pyeti Pepën dhe i tregoi njërin prej të dyve, atë të shkurtrin.

- Po. Nga e njeh?

- Dhe ky zoti Foti? - vazhdoi Luisi.

- Ai është!

Pastaj u kthye dhe më vështroi mua, pastaj Sitistin dhe në fund Pepën.

- Dhe kjo, sigurisht, është Polikseni, apo jo?

- Ajo është, - i përgjigjet Pepa gjithnjë edhe më i çuditur.

Ishte i sigurt se kurrë nuk i kishte folur njeri tjetër Luisit për këtë fotografi. Ku dreqin e dinte cili ishte njëri dhe cili tjetri?

Kaloi rreth një minutë heshtje. Vështrime, ngërdheshje, habi. Në fund Luisi, shumë i qetë, shumë enigmatik, rrudhi pak buzët, ktheu mbrapsht fotografinë dhe lexoi me zë të lartë:

- “29 qershor 1947, dhuratë për festën tënde.”

Poshtë kishte edhe një nënshkrim. “Foti Dhemena.” Pikërisht në këtë moment, vuri buzën në gaz. Ne të gjithë e vështronim. Kishim ngrirë si statuja. As frymë nuk merrnim. Ai, pa iu dridhur qerpiku, e ktheu përsëri fotografinë nga fotoja dhe e vështroi sërish. Ashtu si të sheh në sy okulisti kur të viziton? Si i dëgjon rrahjet e zemrës tënde kardiologu? Ashtu. Edhe pak dhe do ta shihnim të nxirrte stetoskopin dhe mikroskopin. E mbajti edhe pak, dhe më pas ia ktheu Pepës.

Ishte më se e qartë, Luisi kishte nxjerrë përfundime, kishte ndërtuar historinë e tij.

- Ditën tjetër, më 30 qershor, zbritën banditët dhe e vranë, - i thotë Pepa duke pritur të shihte sesi do të reagoje Luisi.

- Ndërsa më 29, një ditë para vrasjes së tij, ishte festa e vëllait tënd domethënë. A nuk e quanin Petro? Apo Pavlo?

- Po, Petro! - ia bëri Pepa dhe mbeti si i hutuar dhe pa fjalë nga habia. - Nga e di ti këtë?

Luisi, në vend të përgjigjeje, u ngrit të ikte.

- Hajdeni, djema, shkojmë, mbaruam punë.

Në atë çast Pepa e kap nga spaletat.

- Prit! Diçka mendove ti, diçka di.

Dhe e uli poshtë me zor.

- Çfarë do, zoti Pepa? Zoti Foti jeton akoma. A nuk jeton? Domethënë ke mundësi ta pyesësh. Gjithsesi, ai nuk ishte me banditët. Apo ishte?

- Jo sigurisht! Me të tjerët, - i thotë Pepa.

- Në rregull, mjafton. Na thuaj vetëm ç'të detyrohemi dhe do të ikim.

E luante për mrekulli rolin e tij, i poshtri.

- Manol, nuk del i gjallë prej këtej, po nuk i the të gjitha ato që mendove.

Madje po belbëzonte. Por Luisi nuk tha asnjë fjalë, nuk arriti. Pepa kishte pirë kaq shumë, sa kur po bënte të ngrihej e ta kapte Luisin, u plas përsëri në karrige dhe e zuri gjumi.

Ku të na zinte gjumi në mbrëmje, në fjetore. Syri pishë. Dhe befaz shoh Luisin të kthehet nga unë, ma bën me shenjë dhe ngrihet.

- Po dal jashtë. Hajde...

Hodhi përsipër kapotën, mori edhe cigaret e tij - *Santé* - dhe doli. Gjoja për të urinuar.

U ulëm jashtë tualeteve, mbi disa fuçi nafte bosh. Pasi ndezi cigaren dhe e thithi nja tri-katër herë, filloi:

- Shiko, kushëri. Historia e Pepës më mbeti në mendje.

Dhe nxjerr nga xhepi i kapotës të njëjtën fotografi. E kishte vjedhur.

- Dhe jo vetëm historia. Dhe gruaja.

Atëherë nxjerr një elektrik dore dhe e ndriçon. Tani e vura re më mirë edhe unë. Me të vërtetë, kishte diçka magjike mbi të. Është nga ato femra që nuk i harron. E pe një herë? Kaq ishte, të mbeti përgjithmonë në mendje.

- Kushëri nuk besoj se i besove marrëzitë e Pepës, se të vëllanë ia vranë partizanët. Ç'punë kishin partizanët të vrisnin këtë njeri? Pres unë kokën, nëse atje kanë ndodhur çudira.

- Domethënë?

- Ose usta Fotit i mbetën sytë te Polikseni, ose tek ullishtat e saj, ose te të dyja bashkë.

Atëherë e vështrova sërish fotografinë më me vëmendje. Kishte të drejtë. E kishte përpirë. "Ose ekzistonte një lidhje që më përpara, ose e kishte krijuar vdekja e Petros, nuk e di", kështu mendoja.

Ndërkohë Luisi kishte tymosur njëra pas tjetrës tri cigare. Po e kuptoja se nuk mbaronte këtu historia. Nuk flisnim.

E dija dhe e shihja se tashmë Luisit kishte filluar t'i punonte mendja larg.

- Sa vjeç mendon se është? - më thotë.

- Përderisa vrasja u bë në 1947-n, sot duhet të jetë... Sa? Njëzet e tetë? Njëzet e pesë?

- Kaq.

Dhe merr fotografinë, e vendos në xhepin e kapotës dhe ngrihet.

U kthyem të heshtur dhe të mbledhur kruspull në fjetore. Madje kur po shtrihej më hodhi edhe fjalën e fundit:

- Sidoqoftë, e kam të pamundur të besoj se kjo grua kishte rënë në dashuri me një qelbësirë të tillë.

Dhe u shtri.

Që atëherë historia filloi të merrte brenda meje përmasa mitike.

Që prej asaj nate, kaluan edhe pesë të tjera dhe, në asnjërin prej tyre, nuk e pashë Luisin të flinte në fjetore. E kishte rregulluar që çdo natë të ishte në shërbim.

E vështrova kur po pinim çaj në mëngjes, teksa rrinim ulur në stola, njëri përballë tjetrit. Ai nuk thoshte asnjë fjalë, rrinte kokulur dhe i heshtur. Sfinks. Me një vështrim të largët dhe të përhumur. Vetëm të shtunën në mëngjes, kur sapo fillova të rrufisja çajin, më tërhoqi nga dora.

- Prit, do t'i mësosh të gjitha përnjëherë, po t'i ruaj si surprizë.

U shtanga, me gavetën në dorë, si i ngrirë, me vështrimin ngulur te sytë e tij.

- Më thuaj... nga e dije se vëllanë e tij e quanin Petro?

Buzëqeshi.

- Aty të ka ngelur mendja? Edhe babanë tim e quajnë Petro. E harrove? A nuk shkruante se më 29 qershor ishte festa e tij?

- Maskara, - i thashë në vend që ta puthja.

Dhe atëherë ai, enigmatik dhe i buzëqeshur, nxjerr qetë-qetë paketën me cigare, e hap dhe më ofron një cigare. E dinte se nuk tymosja.

- Merre, do të të bëjë mirë.

E vështrova, buzëqesha dhe zgjata dorën. Kështu, me Luisin përballë, në KEN-in e Korinthit, piva cigaren e parë.

- Tani do ta shohësh se sa lehtë do të rrjedhin ditët e tua.

Dhe kështu ndodhi.

Nuk e kuptova kurrë përse ky njeri tregonte kaq dobësi për mua. Një drej i sha, i trishtuar, frikacak, pa prokopi. Nuk kisha asgjë që të zgjonte interes në personalitetit tim, një kureshtje, një nivel tjetër. I ndershëm vetëm. Isha ai që tregohesha, pa enigma, pa teatralizma dhe të tilla si këto, ndërsa Luisi vetë ishte e ç'nuk ishte. Dhe vetëm të flasësh



me të ishte një aventurë më vete. Kudo që ta prekje, lëshonte xixa. Magjistari, i pandershmi, i bukuri!

Kureshtja ime, ndërkohë, kishte arritur në pikën më ekstreme. Imagjinoja çudira. Më dukej se ishte i aftë për të bërë gjithçka: të zbulonte, të themi, disa letra të zverdhura të zotit Foti, nga të cilat do të dilte edhe pabesia e Poliksenit, ose ta dhunonte, ose ta tërhiqte një natë nga flokët dhe ta sillte përpara Pepës dhe aty ta detyronte të rrëfente krimin. “E dashuroja dhe vrava”, dhe të tilla si këto, melodramatike dhe të pabesueshme. Vetëm kështu e imagjinoja. Deri ditën ku, unë përfaqësoja Fotin në prag të vdekjes dhe Luisi i maskuar si prift duke imituar rrëfyesin e tij. “Fol për të gjitha mëkatet e tua, nëse do të fitosh një copë Parajse”, dhe ai do të fliste. Foti Dhemenaga do t’i kërkonte Poliksenit të thërriste priftin që ta kungonte dhe ajo, ndërkohë, do të ishte vënë në dijeni nga Luisi, në vend që t’i sillte priftin e kishës, do të sillte tjetrin, të rremin.

I kisha imagjinuar të gjitha dhe ai ishte i aftë për të gjitha. Të zhvarroste histori të tmerrshme dhe të frikshme për Fotin, me dokumente nga letra, dëshmi, fotografi. Të hiqej herë si bashkëpunëtor, tradhtar i maskuar i gjermanëve, herë të ishte frika dhe tmerrri i fshatit, herë... Të them, për të gjitha ishte i aftë. Vetëm një gjë nuk mund ta imagjinoja se do t’ia arrinte, por ia doli mbanë edhe për këtë. Dëgjo që ta admirosh këtë njeri, dëgjo:

Një mbrëmje, pas disa ditësh, kur unë dhe Sitisti shkuam të rrëkëllenim ndonjë gotë të “Harula” - “Shkojmë, Manolopulo?”, “Shkojmë” - merre me mend se ç’pamë. Pepën dhe Luisin të bërë xurxull duke kërcyer tango në mes të sallës. Me të vërtetë. Dhe jo vetëm kaq. Pamë rreth e

rrotull, të gjitha muret të zbrazëta. Nuk kishte asnjë citat patriotik. As ato si “Rroftë Ushtria” e as “Komunizmi, opiumi i popullit”. Kishin hequr nga muret gjithçka, madje edhe atë afishen porno.

Të gjitha i prisja, por ta bënte Luisi të majtë edhe Pepën, kjo s’ më shkonte në mendje.

Nuk e di se sa zgjati metamorfoza ideologjike e Pepës, por mendoj se është gjëja më mbresëlënëse që ke dëgjuar ndonjëherë.

Harula, sapo na pa të hynim, filloi të na lutej për diçka që nuk e kuptova menjëherë.

- Zoti Manolopulo, shpëtojeni dyqanin tonë, bëni diçka, kanë shkalluar. Kisha rënë të flija, isha pak si pa qejf, dhe papritur i dëgjova. Hidhnin poshtë e lart afishet, shqyenin defterët e mësuesit, shanin Caldharin<sup>1</sup>...

E imagjimon dot këtë pamje? Në sfond dëgjohej një tango, rolin e damës së Pepës e luante Luisi dhe kërcenin *ala Rudolf Valentino*, me hapa të mëdhenj dhe me duart të shtrira plotësisht. Bënin poza. Megjithëse u merreshin këmbët nga e pira. Kur arrinin pozën, Pepa i hidhej Luisit dhe e puthte.

Disa klientë të tjerë, të përqendruar dhe të dehur nga ajo shfaqje, u hidhnin pjata, duartrokisnin, bërtisnin. Bëhej nami. Dhe vazhdonin të thërrisnin “Rroftë Pepa”, dhe vazhdonin ta rrëkëllenin recinën si ujë, dhe Harula vazhdonte të na lutej t’i shpëtonim nga ajo situatë.

Në të vërtetë, gjërat ishin shumë serioze. Nuk kishte dyshim se nga çasti në çast ose do të hynin horrat e milicisë,

---

<sup>1</sup> Panagis Tsaldaris (1868-1936), lider i Partisë Popullore dhe kryeministër i Greqisë së asaj kohe.

t'i shkatërronin të gjitha dhe t'i zhdëpnin në dru - gjë që nuk u shmang në fund - ose do t'i arrestonin xhandarët.

Atëherë e vura re më me kujdes Harulën. Ishte ngritur siç ishte nga krevati i “mëkatit”, aty ku e gozhdonte Pepa për të ngjizur pasardhësin: gjysmë e zhveshur, me shpatullat dhe gjinjte thuajse lakuriq, me një fustan nate prej najloni të lirë, të kuq flakë, si zjarr, të shkurtër deri në gju, trashaluqe si gjithmonë, bishë siç i thonë, dhe fytyra e saj ndriçonte si hëna e gushtit.

Hera e parë që ndjeva dëshirë të tillë për një femër. E vështroja. E vuri re.

- Zoti Kosta, ndalojini. Nuk do të na dalin për mirë të gjitha këto...

Iu afrova. Luisi, mes gjithë asaj rrëmuje, më shkeli syrin me nënkuptim dhe bëri shenjë nga Harula. E kuptoi.

- Hajdeni, vishni diçka, do të ftoheni, - i them.

Dhe e kisha me të vërtetë. E shihja që dridhej, pasi atë natë bënte një i ftohtë i acartë. Acar dhe hënë. Hënë e plotë!

E shtyva në drejtim të kuzhinës.

- Fillimisht vishuni.

- Në burg do t'i fusin.

- Po pse? Ç'po bëjnë? Nuk janë dhe aq...

- Nuk janë? Para se të hynit këndonin dhe këngë partizane. Provokojnë, bërtasin. Po bëhen gjithë këto ditë që nuk keni ardhur, nuk e dini... Kanë ndodhur shumë gjëra.

Hapa derëzën që komunikon me dhomën e ndenjjes - tani e njihja atë vend - dhe e shtyva brenda.

- Fillimisht duhet të vishni diçka, ndryshe do të ftoheni.

Dhe u futëm brenda, ndërkohë që derën e lamë të mbyllej vetë.

Me kërcitjen e bravës së derës, zgjata duart dhe e përqafova. Instinktivisht. Nuk po përmbahesha. E putha.

Tamam-tamam nuk e dija akoma si puthin njerëzit. Por dëshira ime ishte kaq e zjarrtë, sa edhe Harula, pas disa sekondash ngurrimi dhe habie, u dorëzua, pa marrë mundimin të ruante as edhe dukjen.

Kanapeja me krahët e shëmtuar ishte gjithnjë aty pranë dhe pasqyra po përballë. E tërhoqa mbi vete. Nuk kundërshtoi. Sy ulur, si të flinte, u dorëzua.

Atëherë, shumë pa takt, në mënyrë shumë primitive, ia ula njërën tirandë të këmishës së natës, poshtë shpatullave. Iu zbulua i gjithë gjoksi. I fortë, i bardhë, me thithka gjigante, të rrumbullakëta dhe të zeza sterrë. Kur po ia hiqja mbathjet, u nervozova, sepse u ngatërrua dhe nuk hiqej.

- S'ka gjë, - më thotë duke pëshpëritur. - Lëre.

Dhe e lashë të varej nga njëra këmbë.

E humba toruan. Nuk dija ç'të bëja më parë. T'i puthja buzët, gjoksin apo ta përqafoja? Dukej sikur një lumë vërshonte mbi ne, si të godiste në digë, dhe ne aty, mes dallgëve, luftonim.

Herë përkulesha dhe i puthja kërthizën, herë ngjitesha më lart, te gjinjtë, pastaj te thithkat.

- Sot vdes fashizmi! - bërtiste jashtë Pepa.

E dëgjoja, por dhe nuk e dëgjoja.

- Jo, mos, - më pëshpëriste Harula dhe më tërhiqte nga flokët që të ngjitesha sipër, lart, ta puthja në buzë.

Donte - ndoshta sepse i vinte turp - parapëlqente, të qëndroja me fytyrë pranë fytyrës së saj. Ndihej më rehat kur shiheshim në sy.

Pikërisht atëherë, të përqendruar, duke gulçuar, thua se i ishim ngjitur malit me këmbë, e tërheq mbi vete, teksa po

shtrihesha mbi kanapenë me krahë. Tashmë e kishte humbur kontrollin. Aq shumë, saqë vetë më zbërtheu pantallonat, vetë m'i uli së bashku me benevrekët, me mbathjet, vetë, me disa lëvizje të shkathëta, para-mbrapa, ia doli mbanë dhe hyra brenda saj.

Pastaj filloi ato lëvizjet e saj të lehta e të njohura, pikërisht ashtu si kishte ndodhur me Luisin.

Te pasqyra përballë shihja gjithë skenën. Shpinën e saj, mesin, të pasmet, të ngjiteshin e të zbrisnin. Vetëm pak sekonda zgjati. Ulërima e saj, kur po mbaronte, ishte diçka e papërshekrueshme. U tremba. Deri atëherë nuk kisha dëgjuar diçka të tillë. Si të shqyhej, si t'i shkëputeshin rropullitë, si ujkonja kur ia marrin fëmijët, një hingëllimë dhimbjeje dhe çlirimi njëkohësisht.

Nuk e di, këto gjëra nuk përshkruhen, humbin magjinë e tyre. Janë për t'u jetuar. Në të njëjtin çast po mbaroja dhe unë bashkë me të.

Ndjeva se i nxehti i saj më përshkoi gjithë trupin, e gjithë kënaqësia e saj, si një lëng i trashë, i rrjedhshëm, që më hynte në gjak.

Duart e saj, që i kishte kaluar poshtë këmishës sime, më ishin ngulitur në kurriz, dhe ashtu qëndruam, të përqaftuar, duke marrë frymë thellë.

Dalëngadalë nisa të merrja veten, të fitoja ndërgjegjen e vendit dhe të realitetit.

Veshët e mi fituan pak e nga pak dëgjimin, sytë e mi të parin, mendimi frikën.

Filluam të dëgjonim sërish zërat pranë nesh, përplasjet e duarve dhe ca nota *primo sekondo* të muzikës së buzukut. Ndoshta ishte zëri i Markos, mendoj.

- Gjithmonë, kur prishem, më duket sikur për një kohë të gjatë dëgjoj nga larg disa kambana. Ti?

- Unë dëgjoj tinguj, por pa e ditur saktësisht burimin e tyre, me çfarë ngjajnë! Tinguj të papërcaktuar, me mijëra.

Nuk di nëse arrita ta mbaroja fjalinë. Pikërisht atëherë u dëgjuan bam-bumet e para, si të thyheshin xhama, dyer, drurë. Shfaqja e Dytë. Dëgjoje të shara dhe gota e kana që thyheshin mbi mure, në dysheme, pjata që fluturonin jashtë dritareve dhe bëheshin copa-copa poshtë pemëve dhe mureve të vathës.

Bashkë me pjatat dëgjoje të fluturonin dhe të thyheshin edhe tavolina, karrige, këmbë karrigesh.

- Zoti im! - tha Harula dhe u ngrit.

Vetëm sa arriti të vishte mbathjet. Në vend të fustanit - ku të kërkonte ta gjente në atë orë - hodhi përsipër një mbulesë tavoline të madhe të thurur, borë të bardhë, që e tërhoqi nga një tavolinë.

Unë përpiqesha të ngrija benevrekët, pantallonat, kërkoja të gjeja vrimat e kopsave, rripat, ushkurët, të mbërtheja xhaketën ushtarake, pantallonat... Ja ku më gjeti! Frika e prindërve. E dija mirë. Po të më kapte Policia Ushtarake, nuk do të më shpëtonte asnjë. Me dy pistoletat që u shkrepën papritmas, i lashë të mbërthyerat dhe rripat, mbajta me duar pantallonat që të mos më binin, hapa dritaren, u hodha, thua se po bëja kërcim së larti, dhe kalova kopshtin.

Ndala për një çast, përballë, për të parë Luisin dhe Sitistin. Plumbat kishin hapur vrima në fuçitë që ishin mbi tavolina. Shihja të rridhte recina *Nemeas* e Pepës, dyllë e verdhë, thua se po shurrnin nga lart. Të kujtonin shatërvanët e vegjël, ose burimet që gufonin.

Arrita të shihja vetëm Harulën të tmerruar ndërsa hynte në sallë, me mbulesën e tavolinës mbi këmishën e natës prej najloni flakë të kuqe.

Mes gjithë kësaj zallamahie, ashtu siç ishte gjysmë e zhveshur, ngjante me një femër haremi, me një personazh të një tjetër historie.

Punë sekondash pashë edhe Pepën, që e kishin shtyrë në një cep - sulmuesit paraushtarakë - dhe e gjuanin me grushte, ndërsa mbi fytyrën e tij binte recina.

Disa klientë të tjerë, në një cep, të palëvizshëm si pula të lagura, bënë sikur nuk shihnin, se gjoja vështronin diku tjetër.

- Vrasës! - dëgjova Harulën të thoshte dhe e pashë t'ua vërsulej përsipër.

Në atë çast nuk munda të shihja as Luisin as Sitistin. "Në raste të tilla, më mirë shpëto veten", thashë dhe ika.

\*\*\*

Pas një çerek ore arrita në repart. Pasi kisha kapërcyer gardhe dhe tela me gjemba, gjendesha në fjetore. Ke parë ndonjë qen në mes të zhegut, të vrapojë dhe të gulçojë? Kështu isha unë, kur hyra. Si qen me gjuhë përjashta. Le që frymë nuk mund të merrja, por edhe po të doja fryma nuk më dilte; edhe një minutë më shumë, dhe zemra ime do t'ia kishte bërë krak, si kordë e tendosur shumë që thyhet.

- Po ç'drejtin patët sonte? - pyeti nënoficeri i fjetores, ndërsa bija me kurriz në krevat.

Vetëm atëherë, shumë pranë, dëgjova të njëjtën gulçimë. Kthehem dalëngadalë, dhe, ç'të shoh? Luisin, që gulçonte, edhe ai me kurriz, më vështronte me ata sytë e tij çapkënë.

Dhe të donim të flisnim ishte e pamundur. Vetëm frymëmarrje të thella nxirrnim.

Kishte ikur edhe ai nga sytë këmbët.

Përballë, nga dritarja e fjetores, pashë hënën. E plotë, e mbushur, e argjendtë.

Kthehem sërish nga Luisi. Edhe ai ia kishte ngulur sytë hënës.

E tepërt, sigurisht, të të them që sapo ndala së rënkuari më kaploi frika. Po sikur të më kishte tradhtuar ndonjë te komandanti, po sikur të më kishte kapur syri i ndonjë rrufjani, asgjë nuk do të më shpëtonte. Jam që jam i njollosur, por të dilte edhe se kisha nxitur drejt komunizmit një qytetar paqësor si Pepa? Për Sitistin nuk dija asgjë se ku kishte shkuar, më kishte shpëtuar, ç'ishte bërë me të pas bastisjes së vandalëve.

\*\*\*

Në mëngjes po pinim çajin tonë, unë dhe Luisi, të përkulur dhe të heshtur, dhe për më tepër, unë isha ende shumë i frikësuar.

Bëra të njomja pak koromanen, por e lashë. Asgjë nuk më shkonte poshtë.

Luisi pranë meje, si të mos kishte ndodhur asgjë, e pinte çajin tërë qejf, njomte koromanen dhe shijonte mëngjesin.

Një ditë pranvere. Diell, qiell i pastër, pa acar. Vetëm një fllad. Kudo. Në pemë, në stola, në xhama dhe nuk ndieje të ftohtë.

- Mos të ta bëjë syri tërr. Ke bërë ndonjë gjë? Nuk ke bërë, - më foli papritmas, thua se ma kishte lexuar mendjen.



- More Manol, - i them, - nuk kupton? Po sikur të të shkojë e gjithë historia këtu në komandë... E di se ç'thoshit dje me Pepën? Ç'këndonit, e di? Këngë partizane, më e pakta.

Buzëqeshi.

- Qepe. Vetëm *Kombaricën* këndonim dhe kërcenim. Vetëm këtë ke dëgjuar ti.

U tmerrova. Jo. Për herë të parë ndjeva më shumë një si pështjellim. “Me shaka, pa shaka, kështu i pakujdesshëm dhe sipërfaqësor siç është Luisi, mund të ngatërrohem i keq.” Para dy ditësh në komandë kishte mbërritur çnjollosja ime. Kaloja nga klasa e tretë në të dytën. Gjithmonë i dyshuar, por shpejt do të radhitesha krah atyre që nuk janë kundërshtarë të regjimit, por që përshtaten me të.

Për ty që po i dëgjon tani, sigurisht, mund të jenë shumë pak të njohura dhe të pabesueshme, por nuk është keq t'i dish.

Madje më thirri komandanti, Kricini, që vetë ai të ma bënte të ditur.

- Je në rregull, Manolopulo, njolla t'u hoq. Për nja dy vjet, bën një kërkesë të re, kështu që nuk do të kesh probleme.

Unë, sigurisht, as kërkesë çnjollosjeje nuk kisha bërë, as nuk dija gjë. Bëmat e nënës sime këto. Do të kishte shkuar, me sa duket, te xhaxha Anesti. “Po të lirohet i njollosur kaq rëndë, nuk do të ketë të ardhme djali. As gjyqtar nuk do të mund të bëhet, as nëpunës civil...” Dhe xhaxha Anesti ishte mik me drejtorin e policisë në Sigurimin e Pireut. Në gjueti bashkë, me pushime bashkë, në kafene bashkë. I kishte thënë “më sill një kërkesë të tij, t'ia rregulloj këtë punë”. Dhe ma rregulloi.

- Të shoh të menduar, Manolopulo, - vazhdoi Kricini.  
- Ndërsa normalisht duhet të fluturoje nga gëzimi. Pa

certifikatë mirësjelljeje, e di, as thirrës gjyqi nuk bëhesh! E jo më gjyqtar, siç ëndërron.

Unë, sigurisht, nuk kisha ëndërruar ndonjëherë të bëhesha gjyqtar. Ishte ëndrra e nënës sime. As avokat. Edhe kjo ishte ëndrra e nënës sime. Avokatllëku.

- Më telefonoi vetë drejtori i Sigurimit të Pireut, që të të kem kujdes, - vazhdoi Kricini.

E vërteta është se as të përmbysja regjimin nuk kisha menduar - nuk ishte në synimet e mia - dhe as nuk do të doja të vdisja në varfëri. Me shumë gëzim, sigurisht, do të më pëlqente ta përmbysnin të tjerët, jo unë.

Mënyra si po më fliste komandanti po më vinte në siklet. Megjithëse, ta themi mes nesh, kjo “çnjollosje” më bënte mirë; përndryshe kur të lirohesha nga ushtria nuk do të gjeja as punën më të vogël.

\*\*\*

Kur pashë se Luisi i kaloi kaq lehtë ngjarjet me Pepën, fillova të ndihesha disi i pakënaqur. “Kjo cektësia e tij nuk do të na dalë për mirë” - mendova, madje ia thashë.

- More Kostandin, sa frikacak qenke, sa fajtor e bëke veten, çlirohu pak.

Doja t’i flisja për çnjollosjen, për xhaxha Anestin, ç’ më kishte thënë komandanti për të ardhmen, për shkumësin... “Ekziston, Manolopulo, një shkumës. Nuk ka shumë rëndësi kush e mban. Por ai që e mban, ka pushtetin për të vijëzuar kufijtë ku do të lëvizësh. Brenda kufijve lejohen të gjitha. Jashtë, ndalohen të gjitha.” Broçkulla të tilla më thoshte komandanti. Vetëm se, kur m’i thoshte, shtirej

kaq mirë, sa fillova dhe unë të shihja ngado vija të bëra me shkumës.

- I di të gjitha, Kostandin, m'i tha Sitisti. Mirë bëre.

E humba. Dhe vazhdoi:

- Vetëm ki kujdes mos të të marrë për poshtë. Po e more seriozisht çnjollosjen, u dogje. Rrobaqepës do të të katandisin.

Dhe, atëherë, vura re se pranë nesh rrinte i ulur Karandoni, rrufjani i batalionit. Përgjonte. Gjoja përhumbej në ëndrra atë mëngjes pranvere, ndërsa përgjonte.

- Unë as kërkesë për çnjollosje nuk bëra. Asgjë. Nëna ime, - i them duke i pëshpëritur.

- Mirë bëre, por të thashë, mos e merr edhe shumë seriozisht. Kështu do të varesh nga çdo rrufjan si Karandoni.

Fjalinë e fundit e tha me zë të lartë, kinse, që ta dëgjonte. Dhe e dëgjoji. Karandoni hodhi cigaren, madje e shkeli, kryqëzoi pak duart, bëri gjoja sikur pa orën, sepse nxitonte, dhe iku.

Ndërkohë doja ta pyesja se ç'u bë me Pepën dhe me Harulën, ç'kishte marrë vesh për Poliksenin, kush e kishte vrarë Petron, nëse e njihte, e të tilla. Por nuk arrita.

Pas pak erdhi një tetar me një ushtar dhe ndalën para nesh.

- Hajde, i paudhë, të do komandanti, - vazhdon t'i thotë Luisit, dhe ai, si aristokrat i lindur, rrufiti gllënjkat e fundit të çajit, mblodhi në grusht cigaret, çakmakun dhe u ngrit.

- Hajde, more, lëviz, s'jemi në festë këtu.

Dhe tetari i dha një të shtyrë. Çakmaku dhe paketa i ranë në tokë. Bën të përkulet që t'i marrë...

- Lëri, nuk të duhen, - i thotë ushtari, dhe ia shkel me këmbë.

I hidhte përpjetë dhe qeshte.

Bëra të ngrihesha, të protestoja. Më uli poshtë tetari.

- Ti, s'ke parë gjë.

- Nuk është e nevojshme, Kostandin, - shton Luisi. - Djemtë janë në anën time. Gjatë rrugës, do ta gjejmë gjuhën e përbashkët.

Dhe ma shkeli syrin.

Jam i sigurt se, derisa të arrijnë në komandë, do t'ua ketë mbushur mendjen, do t'i ketë bërë të dy për vete.

Luisin nuk mund ta urresh e as t'i bësh keq. Nuk është nga ata njerëz të cilët i injoron kollaj, të bësh sikur nuk i sheh.

Siç i shihja të largoheshin, e kishin kapur për mes, vura bast "Mos më thëncin Kostandin", kur të kenë arritur në komandë, do t'i ketë futur në xhep.

U ngrita dhe i ndoqa derisa u kthyen në kantinë. Pikërisht në kthesë, pashë tetarin të nxirrte paketën dhe ta qeraste me cigaret e tij, kurse tjetrin t'i nxirrte çakmakun dhe t'ia ndizte.

\*\*\*

Në mbrëmje, kur shkova në fjetore, krevati i Luisit ishte bosh. Gjërat e tij dhe çanta e tij e shpinës nuk ishin.

Askush nuk dinte gjë. As Sitisti.

- Sidoqoftë në shkollën e edukimit nuk është, - më tha.

- Transferim?

- As që bëhet fjalë!

- Thua se e kanë çuar në gjyqin ushtarak?

- S'ka mundësi. Do ta dinim.

- Ndonjë gjë më e keqe? - e pyeta. - Po dëgjojmë kaq shumë vetëvrasje. Mund ta kenë bërë të vrasë veten.

- Luisin? E beson ti këtë? - dhe buzëqeshi.

Kaluan shumë ditë e shumë net, dhe asnjë lajm. Ai, sigurisht, që të na bënte të plasnim nga kureshtja, mund edhe të fshihej me qëllim.

Natën e nëntë, kur isha në banjë, bënte një i ftohtë i padurueshëm, po laja dhëmbët dhe më kujtohet që më dhembnin, uji ishte kaq i akullt. Akoma nuk kishte rënë zilja e pushimit dhe, ndërsa po përkulesha të pështyja në lavaman shkumën, papritmas, dikush më preku në shpatull.

- I paudhë, kam një shënim për ty.

Kthehem dhe shoh pas meje tetarin, ai që kishte marrë Luisin dhe e kishte çuar te komandanti.

- Fshihu, ke pastë dhëmbësh.

U fshiva.

- Ku është ai? Që kur e morët, nuk e ka parë kush.

Qeshi si torollak.

- Kë? Recinën? Nuk e ditke? Mik i ngushtë me komandantin.

Njeri për të gjitha punët.

Fliste dhe qeshte. Si i trashë, si idiot. Në fund, kur u ndërgjegjësova për anën komike të gjërave, nisa të qeshja edhe unë, si i trashë, si idiot.

- Merre.

Dhe mora shënimin.

Lexova: “Kostandin, lahu, parfumohu, dhe shko direkt te vendroja. Thuaji vetëm emrin tënd dhe do të të japë një lejedalje për sonte. Poshtë, në buzëdetin e Korinthit, është një hotel, ‘Belle Vie’, quhet. Atje do të më gjesh. Merr dhe para me vete. Ekziston edhe Parajsa. Do ta shohësh”.

Ta thashë, kur ti bën shoqëri me Luisin, jeta jote nuk ka as fillim e sa fund, nuk rri asnjëherë rehat, nuk ngec asgjë, nuk mbaron asgjë. Edhe vite të kesh pa e parë, ti gjithmonë

do të presësh një shenjë nga ai, një lajm, madje edhe atë më të çmendurin, më të pamundurin. Kështu, më kujtohet njëherë, kur sapo po përpiqesha ta harroja dhe ja, në mes të natës, befas, “dring!” telefoni. U tmerrova!

“Kostandin, shkruaj, ‘Kallergi 145’, Pire. E shkrove? Hajde të më takosh. Tani”, dhe ma mbylli.

Gjëra të çmendura, të them. Dhe shkova. Shkëmbinj, plehra dhe ujëra të ndotura.

Nuk e di, por në një shoqëri tjetër, disi më ndryshe, Luisi do të mund të drejtonte banka, fabrika, ose do të bëhej diplomat karriere, ministër i Jashtëm, ç’të duash, yll i kategorisë së parë.

Ndërsa isha duke ecur në një rrugë me dhé, mendoja, ku dreqin e kishte gjetur telefonin në atë orë, në mes të natës, dhe pse më kishte marrë.

Në atë kohë, që të kishe telefon në shtëpi, duhet të ishe doktor, bashkëpunëtor ose bakall. Dyqanet e bakallëqeve ishin qendrat telefonike të kohës. Për shkak të telefonit, fytyra më e lavdishme e lagjes, ishte bakalli. Doktorin dhe bakallin.

Në të gdhirë dëgjoje: “Kaliopi, kandidati yt për dhëndër, telefoni!”, “Urani, yt atë, telefoni!”, “Katerina, xhaxhai!”. Të tilla.

Fije e për pe dinim jetën e të gjithëve nga telefoni. Ndarje, vdekje dhe krime. Të gjitha dilnin në shesh nga telefoni.

Në cep të lagjes, bakalli bërtiste dhe ti sheh të vrapojnë Kaliopë, Katerina, Uranira.

Herë me këmishë nate, herë me peshqirë banje, flokëshpupurisur, të pakrehur ose me bikutina.

Pamje e ngatërruar, e papërshkrueshme!